


8JH-1
P24

Ndoc
Papleka



LUMI E DI
KU BURON
POEZI

8JH-1
P24

Ndoc
Pappleka

LIBRARIJA
BOTU MVA
SERB KULTURA



Lumi e di ku buron

POEZI

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

URTIA E ZOGJVE

Atje lart, shumë lart heshtja dhe vëtmia e yjeve.
Zogjtë nuk ngjiten kurrë aq lart,
sa të mos mund të kthehen prapë në tokë,
të çukitin një kokërr grurë, të ulen mbi një degë,
të përshëndetin agimin me cicërimat e tyre.
Zogjtë i kanë flatrat për t'u ngjitur përpjetë,
për të zotëruar largësitë dhe hapësirat...
Të dashuruar pas qiellet, ata s'ndahen kurrë
nga toka.
Urtia e zogjve, urtia e poetëve të vërtetë.

Gurët dhe fjalët

H A P È S I R A T...

Para meje shpalosen hapësira,
qiej agimesh e mbrëmjesh, vise të tokës që e dua
si pema truallin ku ka mbirë.

Lexoj aty gjithçka që ka shkruar kjo kohë,
fytyrat, ballin, sytë dhe duart e njerëzve,
si një libër të madh që s'më lë t'i ndahem.
Vështroj me ngulm pér të korrigjuar vetveten
si një bocë që e ballafaqojnë me origjinalin.

Prek aty magmën e paftohur të jetës,
të vërtetat e mia që i besoj si ajrin që thith,
si diellin që më ngroh, si tokën ku eci...

Pa këto të vërteta do të isha një pemë e vetmuar
pa zogj e pa gjethe.

NË SHREGULLËN E PRANVERËS

Pranverë.

Tani të gjitha vajzat janë të bukura:

lulet që mbajnë në duar kundërmojnë dashuri.

Të gjithë zogjtë e dinë emrin e të dashurës sime.

Një rrëke më mbështillet rreth qafës

e më bëhet shall i kaltër.

Lëndinat më bëhen këmishë të blerta

me sumbulla lulesh.

Bletët e ngatërrojnë çuditërisht zemrën time

me zgjojet e tyre.

Nëpër lëvoret e drurëve lexoj vjershat e pashkruara

të poetëve.

Në vizatimet e pellgjeve të kthjellëta sodit

tablotë e gjenive që énde s'kanë lindur.

Në sytë e pleqve shoh fëmijë që në vend

të një rrethi

rrotullojnë kohën.

Pyes një lumë: Ç'është pleqëria? dhe ai më thotë:

Do të shkoj të pyes detin.

Pyes një gur: Ç'është vdekja? dhe ai më përgjigjet:

Këtë fjalë s'e kam dëgjuar kurrë.

Zogjtë kalojnë tejpërtej kraharorit tim

si përmes degëve të një lisi.

Me ëndrrat e fëmijëve ndërtoj qytete të mëdha
që kurrë s'do të pushtohen.
Rrugët e pyjeve i mësoj të thërrasin e të qeshin
me të madhe.
Marr mësime muzike nga një shi i papritur
që bie mbi gjethet e gjera.
Në mbrëmje rri kokë më kokë me yjet dhe flas me
ta për të ardhmen.
Çdo mëngjes i nis një letër me një pëllumb
komunizmit.

Pranverë...
Tani të gjithë fëmijët i kam zili!

PËRTEERTJA

Si rrezja e diellit
të marsit
që futet në trup të pemës
e i thotë majës: *Zgjatu!*
E i thotë degës: *Nxirr degë të re!*
E i thotë sythit: *Bëhu gjethe, lule, frut!*
E i thotë rrënjos: *Hyr më thellë!*
E i thotë trungut: *Lësho rrënje prapë!*
E i thotë gjethes së verdhë: *Bjer!*
Mendimi i Partisë na gjalleron gjakun,
përtërin gjithë indet e jetës.

TE VARRI I ENVER HOXHËS

Mbaj në dorë një tufë lule:
krahun ma mpijnë si të ishin prej plumbi.

Do të doja t'u rridhte gjaku im nëpër fletë
që të mbeteshin përherë të kuqe, të freskëta!

Prill 1985

Ç U N A K È T

Fshehurazi të rriturve,
çunakët u hipin kuajve që kullotin në livadhe,
i kapin për krife, ua ngulin thembrat në ije,
i ngasin me të katra.

Me këmishët që u gufmohen nga era,
u ngjajnë dragonjve me flatra.

Ata bëhen Muji, Gjergj Elez Alia, Skënderbeu,
pas nëntë vjetësh sjellin në shtëpi Doruntinën,
me Bajram Currin ngjiten në Malin e Hekurave,
i çojnë letra në shtab Enver Hoxhës.

Livadhet e fshatit shndërrohen në Lugje
të Verdha

në Fushën e Vajkalit, në plaja me borë.

Kuajt trokojnë, hingëllijnë,
përpijnë ajrin me hojza:

Në sytë ëndërrimtarë të çunakëve
dynden horizontet...

ZËRI QË TË DHA ZEMËR

Përmes heshtjes erdhi një zë e të tha: Ëndërro!...
Ti ëndërrove hapësira, flatra. Vure buzën në gaz.
Shkëmbinjtë e hirtë rrëth teje të shikuani me mëri.
Zëri të tha: *Nisu për udhë!*... Ti u nise drejt botës.
E madhe ishte bota. Edhe atje gjete shkëmbinj.
Zëri të tha: *Trokit këtu!*... Ti hyre midis njerëzve.
Gjete vëllezër. Qeshe. I harrove lotët.
Shkëmbinjtë zgjatnin kokën tinëz në jetën tënde.
Zëri të tha: *Këndo!*... Ti mësove të bëheshe zog.
Fluturoje te qelli yt ku nuk vinin dot shkëmbinjtë.
U rrite. Ece. Shkëmbinjtë të dolën në udhë.
E përfolën rrugën tënde. Ëndrrat t'i quajtën
iluzione.

Të pëshpëritën në vesh fatin e pluhurit.
Zëri të tha: *Pluhuri është elegji e shkëmbinjve.*
Ec. Fluturo. Këndo... Ti deshe të dish
emrin e këtij zëri që të dha zemër gjithë jetën.
dhe zëri të tha: *Jam te qenia jote.*
Jam buka që ha. Jam gëzimi që ke në sy.
Jam edhe më tepër se kaq: besimi që ke në vetvete.
Jam te të gjithë njerëzit e ndershëm që ke njojur
dhe po aq te të panjohurit. Jam

*te pema që ke mbjellë duke shkulur një gur.
Te drita që ke ndezur duke çarë një mal.
Jam te ti dhe te mijëra njerëz të ngjashëm me ty
si lumi që përbëhet nga pikë uji pa numër.*

ULLIRI I LASHTË

Ai që më mbëltoi te ky breg,
ishte pellazg apo ilir,
nuk e di.

Mbase ishte harkëtar arbër
që më mbolli në prag të martesës
midis rrëthimit të parë
dhe rrëthimit të dytë të Krujës.

Qeshë ulliri i parë apo i njëzeti?...

Ai që më mbëltoi te ky breg,
fytyrën tënde kishte,
ashtin e tij e ke në krah.

Degët prekmi me butësi
si flokët e së dashurës:
nuk mbaj mend sa herë
flakët m'i kanë zhuritur.

Kam në lëkurë plagë shpatash
nga një mijë ushtri.

Në mish kam plumba
nga dy luftëra të përbotshme... IM 161,13

Ai që më mbëltoi te ky breg,
u shtri një çast në hijen time,
pa në èndërr mijëra pëllumba
që i fluturonin në kraharor.

Në èndërr pa
mijëra e mijëra ullinj...

Ti, djalë që më bën vetullore,
rininë e paç jetëgjatë
sa gjelbërimi im!

Ti, vajzë që më ujit rrënjet,
syrin e paç gjithmonë si ulli!

Mirë se vini, të rinj.
Merrni rrathët e trungut tim të moçëm.
dhe bëni me ta unaza dashurie
për këtë tokë.

F L I J I M I

U zu Drini në Fierzë...

Në fillim lumi përmbyti brigjet e tij
të gdhendura gjatë shekujve në granit e në rreshpe.
Përmbyti trungjet e plakura të rrapi, e
që ngjanin me shtatoret e hyjnive pellazge të lumit,
shelgjet e përkulura mbi trupin e tij
si vajtojca flokëlëshuara.

Nuk e donte vajtimin e tyre: po flijohej për dritën.
Përmbyti një nga një urat e moçme:
harqet e tyre do të shfaqeshin në llambat e rrugëve.
Më vonë mbuloi ara, lëndina, vreshta, pemëtore,
duke u hequr të drejtën për t'u mbjellë,
për të lulëzuar, për t'u vjelë:
duke u dhënë të drejtën për të krijuar dritë.
Te pragjet e fshatrave, te dyert e qytetit '

të shpërngulur,

ujërat u stepën një çast:
Si të përmbytnin rrugët? Si të shuanin
shpuzën e vatrave të lashta?
Si të futeshin në dhomat ku fjetën fëmijët,
ku jehona e ninullave hapej si gjeratore e kaltër?

Si të mbulonin lotët, të qeshurat, zërat e njerëzve
me heshtjen e madhe ujore?...
Për t'i shtuar dritën jetës,
bebëza e liqenit të ri midis maleve zmadhohej.

GURËT DHE FJALËT

Me gurë janë bërë thika,
me gurë janë bërë gjyle,
me gurë janë bërë mozaikë,
me gurë janë bërë statuja.

Me gurë janë bërë shtëpi,
me gurë janë bërë kështjella,
me gurë janë bërë faltore,
me gurë janë bërë burgje.

Me gurë janë bërë piramida,
me gurë janë bërë varre,
me gurë janë bërë mokra mulliri,
me gurë janë bërë mokra torturë.

Me gurë janë bërë perëndi,
me gurë janë bërë murana trimash,
me gurë janë bërë sfinksa,
me gurë janë bërë nudo.

Me gurë janë bërë labirinte,
me gurë janë bërë shkallë,
me gurë janë ngulur kufij,
me gurë janë ndërtuar ura.

Kështu ka ndodhur edhe me fjalët
që nga koha e gurit.



NUK ËSHTË E VËRTETË

Flas me ju, fqinjë të thjeshtë, cilado qoftë gjuha
 me ty që kullot tufën rrëzë Olimpit hyjnor
 a peshkon në ujërat e Egjeut,
 me ty që sharron në pyjet e mëdha të Bosnjës
 a korr grurë buzë Danubit,
 me ty që punon në uzinat e Torinos a vjel ullinj
 mbi hirin vullkanik të Etnës:
 Nuk është e vërtetë që unë ju urrej,
 dikush tjetër e ka shpikur urrejtjen!
 Kemi mite, fjalë dhe valle të përbashkëta,
 një vijë ndan fushat, malet, lumenjtë dhe detet
 midis nesh.
 Kemi balada ku digjen si yj dhimbje të njëjta:
 A s'i patëm të njëjtë armiqtë dhe mynxyrat?!
 U përgjak trualli im, edhe në qielin tënd korbat
 erdhën.
 Gurët e vatrës m'i shkulën gjylet e topave,
 edhe shtëpia jote diku u plasarit...
 Nuk është e vërtetë që unë ju urrej:
 gjetiu e kanë shpikur urrejtjen!
 Gjaku im u derdh më 1806 për të çliruar Beogradin,
 gjaku im u derdh më 1822 për të mbrojtur
 Misolongjin,

SHVARTZ I DEJAVUAN SHVARTZ
gjaku im u derdh më 1860 në këmishat e kuqe të Garibaldit,
gjaku im rrođhi deri në Sanxhak mbi borën e 1945-s
për t'u bërë vetëm vëllamëri popujsh, bozhure lirie...
Nuk është e vërtetë që unë ju urrej: e di mirë kush e ka shpikur urrejtjen!
Le t'i çajnë kambanat e zeza priftërinjtë e urrejtjes:
nuk është e vërtetë që kemi lindur në mëri të njëri-tjetrit.
Ne lindëm për të jetuar të lirë: secili në truallin e tij,
duke ruajtur fytyrën tonë si malet që ruajnë trajtën në shekuj.
Liria e secilit është shpati tjetër i malit të lirisë së fqinjit...
Nuk është e vërtetë që unë ju urrej!

SHARKIA E DERVISH SHAQES

Njëqind duar s'do të më mjaftonin
për t'ia falur sharkisë.

Mushkëritë m'i lodhi sëmundja,
duart pleqëria
dhejeta një ditë më tha:
Eja të pushosh
Nën barin e kësaj lëndine!

Po shkoj të qlohem
e po ju lë zërin tim.

Në ju marrtë malli përmua ndonjëherë,
rikrijomani fytyrën me të,
rikrijoni mushkëritë, duart e mia,
fushat e vendlindjes, lumenjtë, kreshtat
e bjeshkëve,
gjakun dhe fytyrat e trimave.

Në dëgjofshi të dalin tinguj
nga sharkia ime e varur në mur,
siç brofin nga një bregore pëllumba të egër,
mos u çuditni:
gishtat e mi ia prekin telat.

Malli i këngës
e mundkérka vdekjen...

Për t'ia falur sharkisë
s'do të më mjaftonin njëqind jetë!

URA PA LUMË*

Muzgjeve me hënë
më duket vetja si një hënëz guri
e mbetur uloke nga pleqëria.

Habitem që gjendem këtu
unë që s'lidh asnjë breg.

Sa shumë kam parë,
sa kohë të vdekura kam mbajtur mbi kurriz,
sa këmbë që s'mbahen mend...

Njerëzit nxitonin mbi mua.

Shkonin në dasma, në tregje, në luftëra:
asnjëri nuک mendonte se një ditë
për herë të fundit do të kalonte
mbi harkun tim të gurtë.

Më lanë këtu
për të lidhur vdekjen dhe jetën
si dy brigje.

* Ura e Tabakëve në Tiranë

... Derisa një ditë lumi im më braktisi.

Nganjëherë më zgjon hapi i një fëmije që vrapon mbi mua:
tërë trupi më dridhet nga këmbët e tij.

Atëbotë zë e ëndërroj që jam kalë
dhe vrapoj drejt një lumi pér të gjetur dy brigje,
pér të mbajtur hapa njerëzish,
pér të shpëtuar nga plogështia e jetës sime.

Ëndërroj një lumë pranvere.

VAJZAT PUNETORE TE PARKU I MADH

Muzgut i japid tē qeshurat,
hijen e shtatit tē tyre.

Djemtē fërgëllojnë si pemë tē lulëzuara
nga flladi i ngrohtë i prillit.

Tunden nē qiell majat e selvive,
si rema hënën e shtyjnë tutje
tē mos u vjedhë prarimin e flokëve,
tē mos u marrë kuqëlimin e buzëve.

Mbështeten te njëra-tjetra si motra,
ato hanë alkullore dhe qeshin...
Mbushet hapësira e muzgut
si me tringëllima qelqesh.

N È N A

Gjithë ditën mban fëmijën në gji
midis drurëve të gjelbër.

Me atë vështrim të përhumbur statuje,
ndjek me sy pleqtë që ecin ngadalë,
fëmijët që luajnë rrëth nënave të tyre,
çiftet që puthen pa e vënë re.

Mbi drurët e parkut bie nata,
rruga zbrazet nga hapat e njerëzve.

Nënës i bymehet kraharori,
nga gjiri i saj pikon qumësht i bardhë
mbi fytyrën e fëmijës që fle.

Fëmija hap sytë, kap gjirin me buzë,
mbështet mbi të pëllëmbët e vogla.

Në qetësinë e thellë të parkut
jehojnë të qeshura fëmije,
pasthirrma e fjalë të ëmbla nëne.
Kalimtari i vonuar ndalet i habitur
midis drurëve të larë në dritë hëne.

PUSHI I KRAHËVE TË FLUTURËS

Si fëmijë kureshtar që isha,
gjatë e kam ndjekur një flutur,
te krahët e kam kapur me gishta.
E kam lëshuar prapë fluturën:
ajo ka ngecur në bar duke u përpëlitur.
Atëherë kam vënë re gishtat e mi
të lyer me një pluhur të butë e të larmë.
Më ka mbetur në mend ajo flutur,
përpëlitja e krahëve të saj në bar...
Më vonë kam menduar se edhe njeriu vetë
ka në qënien e tij flatra të holla
me push të butë e të larmë si fluturat.
Po të prishet ai push fluror,
njeriu i ngjet fluturës së ngecur në bar,
që përpëlitet pa mundur të fluturojë.

VIZITA E STËRGJYSHIT

Ai erdhi për vizitë në shtëpinë e re.
U futëm nëpër dhoma, i tregova mobiliet, orenditë...

Ai kërkonte diçka me sy në faqet e mureve,
duke tundur me qortim kokën e thinjur.
«*Nuk po shoh asnje frëngji!*» tha ai.
Frëngji s'kanë as shtëpitë e tjera, i thashë.
Në dhomën e pritjes u ul te divani që kërkelliti
nën trupin e tij si rrap.

Hapa televizorin ta çudisja me shpikjet e sotme:
në ekran dolën luftanije, bombardues, raketa,
ndërtesa të shembura, grumbuj të vrarësh...
«*Njerëzit u vritkan si në kohën tonë!*» tha ai.
Zura t'i flisja për superfuqitë, për agresionet.
Ai më dëgjoi vetullngrysur, u ngrit që të ikte.
Më kot iu luta të rrinte së paiku një natë,
ai tundi prerazi kokën e thinjur.

Atë çast erdhi im bir i djersitur nga loja.
Ky është stërgjyshi ynë, i thashë,
emrin e tij e kemi mbiemër.
Stërgjyshi pa te fëmija tiparet e tij,
iu zbut përnjëherësh fytyra e rreptë.
Vogëlushit i mbeten sytë te mustaqet e stërgjyshit
dhe iu afroa me buzë në gaz.

«*A di përralla?*» i tha im bir.

«*Di përralla sa deti*» tha stërgjyshi.

Im bir e kapi për krahu dhe e çoi te divani.

Ata ndenjën bashkë deri vonë:

Vogëlushi harroi që kishte gjumë,
stërgjyshi harroi që donte të ikte.

Vogëlushi dëgjonte përrallën e pafundme të jetës,
stërgjyshi s'mbante mend që kishte vdekur.

KIPCI IM

Më ndjek pas në të gjitha rrugët ku eci,
më rri pranë në të gjitha orët e ditës.
Po të pikëllohem, sjell një zog bore
që hyn në zemrën time dhe zë të cicërijë.
Po të kotem me fytyrën e njeriut të kënaqur,
në vend të jastëkut më vë një gur.
Po të hesht, kur duhet të them fjalën time,
nga vështrimi i tij më skuqet fytyra si prush.
Në mes të rrëmetit, të gëzimit të bujshëm,
më kap për krahu, më çon në një shteg pylli.
Nga rrugicat me gjethe të verdha, me mijegull
 të hirtë,
më çon tek autobusët e mbushur me punëtorë.
Po të brengosem nga një dështim, nga një fyterje,
m'i fshin sytë me një degë të celur mimoze.
M'i merr vjershat e dobëta e m'i gris sy ndër sy.
Po të më gjejë të lodhur, të topitur,
më hip në krahët e një fluture të bardhë
e më çon në viset e ëndrrave.
Po të më shohë duke këputur petalet e
 një luleshquerre,
më nxjerr përpara një njeri që vuan
në një vend tjeter a në një kontinent tjeter.
Po ta harroj, e merr vesh më parë se unë

dhe s'më mban mëri që e kam harruar.
Ai **ka** fytyrën e të dashurës, fytyrën e një **miku**,
fytyrën e një njeriu të mirë që s'e kam takuar
kurrë,
që **mbase** ka jetuar para njëqind vjetësh.
Pa të do të isha gjysmak.
Ai s'do të ndahet **kurrë** prej meje.

Eçi nëpër ditën } time

PUNËTORËT QË SHTRIJNË LINJAT E REJA TELEFONIKE

Ditën shtrijnë telat mbi shpate e gremina,
për t'i bërë udhë zemrës dhe zërit njerëzor.

Muzgjeve rikrijojnë shtëpitë e tyre prapa maleve,
me re të kuqërremta, me rreze hëne.

Natën gishtat e tyre rriten si në përralla
deri te mollëzat e fëmijëve, te flokët e grave.

Në sytë e tyre bëjnë çerdhen zogjtë e mallit,
me duart e forta përzënë vetminë nga hapësira.

AUTOKRITIKË NË VETËN E DYTE

Hajt,
mbylli librat ku je zhytur,
lëre *Artin poetik*,
manifestet estetike,
kryeveprat e mjeshtërve;
dil jashtë
të lexosh
librin e madh
të jetës.

Ti mund të bësh figura mahnitëse
për koreografinë e gjethive të verdha,
për velat e èndrrave
në sytë e kaltër të së dashurës,
por a është e ndershme
të mërresh vetëm me figura të tillë
në këtë kohë shqetësimesh, andrallash?!

Eja,
dil në rrugë,
fol me njerëz të gjallë:
dikush u martua,
dikush u bë me fëmijë,
dikujt i vdiq babai.
Fol me bashkudhëtarin që të hap zemrën
në një rrugë të largët fshati,

në një vagon treni.

Fol me njeriun e drejtë që vjen plot besim
dhe për halle jete troket
te zyrat e komitetit.

Hyr në uzina ku metali prushërin,
zbrit në galeritë e minierave.
Atje do të gjesh një lëndë poetike
më të pasur
se në librat e bibliotekave.

Ik nga bisedat
ku fjalamaniët
mbështilen më varak lajkash, thashethemesh.
Poetët janë zogj hapësirash:
ata nuk janë zogj të mbushur me kashtë,
tullumbace me ngjyra,
lule serrash.

Eja,
mbylli librat kù je zhytur.
S'mjafton të lexosh
Homerin, Naimin, Majakovskin, Elyarin...
Pa lexuar librin e përditshëm të jetës,
vjershat e tua
do të janë
vizatime akulli mbi xama!

ECI NËPËR DITËN TIME

Eci nëpër ditën time.

Shoh që s'mund ta mat me hapa as me sy.
Në të ka raste për trimërinë më të madhe,
ka raste për të provuar ndershmërinë e secilit.
Ka çaste kur është e domosdoshme të jesh i rreptë,
të jesh i dhembshur e i butë si vesa mbi një lule.
Në një rrugë gjendesh ballë për ballë Jagos.
Në një rrugë tjetër kalon bri një vajze

me fytyrë Tanushe,
takon me bërryl një njeri që mund të jetë hero.
Përjeton ngjarjet e sotme të rruzullit,
që ndryshojnë më shpejt se trajtat e reve.
Ndien mbi supe barrën e rëndë të ditës
që peshon sa një vit i dikurshëm...
Jam i zënë me ditën time —
shekujt që ikën le të presin te dyert e saj.

BUROKRATËT I KRIJONI JU...

Asnjë burokrat s'ka rënë nga qielli.
Burokratët
i krijoni ju
që rendni prapa një nëpunësi,
duke iu përgjëruar
si mbretit-diell.
Ju që i flisni me gjysmë zëri
dhe ju thahet
pështyma në gojë,
ju që e ndryshoni mimikën
brenda disa çastesh
që nga vuajtja e martirit
deri te buzëqeshja ëngjëlllore.
Ju që heshtni,
kur shkëlet parimi,
(Ai parim është gjaku i të rënëve!)
ju që i mbyllni veshët,
kur zëri i një nëpunësi
godet ajrin e zyrës si çekan i rëndë.
Ju që i përulen
si perëndisë,
kur ju zgjidh një hall,
(këtë gjë ai e ka për detyrë!)
dhe harroni

se nga duart ton a i ka
tryezën e punës, rrobat, shtëpinë...
Ju që s'lini gur pa lëvizur,
që ia njihni
tërë drurin gjenealogjik,
shijet,
miqtë,
temperamentin.
Ju që s'lini vend pa e zënë:
në zyrë,
në rrugë,
që edhe në shtëpi i shkonit të dielën.
Ju që e kapni për krahut,
siç e kap nënën fëmija,
kur shkon në kopsht,
dhe kinse padjallëzisht
e ftoni
për një teke raki e një bërxollë.
Ju
më të paturpshmit,
më dinakët
që fshehurazi i çoni «dhurata»,
për ta marrë me të mirë,
siç u bënин fli hyjnive
popujt e lashtë.

Ju që e quani të gjithdijshëm,
që si guhakë
e dëgjoni,
i buzëqeshni.

Ju që orë e minutë,
trurin e shtrydhni,
për të gjetur ndonjë lajkë
që ta temjanisni sedrën e shefit.

Ju
që kënaqësinë më të madhe ndieni,
kur ecni bri tij
si një kone e urtë...
Mitra e burokratëve
është truri juaj!

O TI, DJALË I FSHESARES...

O ti, djalë i fshesares,
të kam parë nëpër muzg.
Nënës ti ia merrje fshesën,
i thoshe të ulej buzë rrugës.

O ti, djalë i fshesares,
të kam parë nëpër muzg.
Fshesa e gjatë me degë shqope
në krahët e tu bëhej jugë.

Dridheshin si fletë zambakësh
letrat mbi asfaltin e murrmë:
më të bardhët zambakë të botës
ishin dy pëllëmbët e tua!...

Në duart e nënës që çlodhej
dremitnin dy pëllumba.

KËSHTJELLAT E FËMIJËVE NË BREGDET

Trill i fantazisë fëmijërore,
kështjella të brishta rëre.

Edhe një këmbë kalimtari,
edhe ujët e baticës
fare lehtë mund t'i shembë...

Megjithatë te këto kështjella të brishta,
që fëmijët bëjnë në bregdet,
rilindin kështjellat e gjyshërve
të shembura nga luftërat,
mbijeton qëndresa.

VĀJZA QË ECËN NË TROTUAR

Hapat e tu
trokasin në pllakat e trotuarit
dhe e mbushin mëngjesin
me tinguj ritmikë.

Atë çast rruga i ngjet një pianoje
me tasta të panumërtë.

Një degë mimoze
zgjatet dhe të vë në flokë
si karfice të artë
një bisk të lulëzuar.

Duke e ngatërruar pardesynë tënde
me një pemë,
një zog i vogël të ulet mbi sup,
cicëron për ty.

Ti ecën e shpenguar,
me trupin e hijshëm:
i ngjan një mështekne
që ka marrë leje nga toka
dhe ka dalë të shëtisë...

Në pllakat e trotuarit
oshëtijnë hapat e tu:
zgjojnë nga gjumi një botë tjetër,

që kurrë s'e ke parë.

Ja,

pllakat zënë e lëvizin,
hapen si një perde teatri
dhe bota e vjetër
férkon sytë e lëbyrur.

Të sillen përqark perchë të zeza,
zejtarë të kërrusur, të zymtë,
klerikë që pështyjnë me mllef.
Duke të parë ty,
shitësit endacak të gazetave
i mbeten në grykë
lajmet për ballot mbretërore,
titujt e gjatë të princeshave...

Ti ndalesh një çast,
buzëqesh
me atë botë arkaike
të varrosur përgjithmonë,
pikërisht që sot të ecësh
e shpenguar, e hijshme
mbi pllakat e këtij trotuari,
me atë trup prej mështekne.

Bota e vjetër, e zgjuar nga gjumi,
kthehet prapë në mosqenie.
Plakat zënë vend si më parë,
shtrëngohen fort pas njëra-tjetrës
nën këmbët e tua.
Mimozat zgjatin degët,
të vënë në flokë karfica të arta
prej bisqesh të lulëzuara.
Mbi plakat e trotuarit
trokasin hapat e tu:
rruga i ngjet një pianoje
me tasta të panumërtë.
Ti ia fal kësaj dite
muzikën e hapave,
sytë e tu të bukur.

N A T Y R S H M È R I

Çliruar nga shala e meshintë
apo nga samari i rëndë,
çliruar nga imazhi i kalorësve
apo nga imazhi i nuseve,
çliruar nga imazhi i karrocave
që mund të ketë têrhequr,
çliruar nga xhufkat dhe stolitë,
nga mëgojëza, nga freri,
nën shiun e butë kulloste bar të njomë
një kalë i bardhë
me të vetmen stoli:
një vargua rrodhëzash te balli.

TI SILLESH NËPËR DHOMË...

Ti sillesh nëpër dhomë,
fëmijët e vegjël i ka zënë gjumi
me emrin e babit në gojë,
tryeza ka mbetur e shtuar,
ka shkuar vonë:
ku-ku, ku-ku bën sahati në mur...
Ti sillesh nëpër dhomë,
burri yt gajaset në klub,
kolovitet me gotë në dorë.
Hapat po rrallohen nëpër rrugë,
ka shkuar vonë:
ku-ku, ku-ku bën sahati në mur...
Ti sillesh nëpër dhomë,
muret e kaltra të duken ngjyrëplumb,
perdet e tylta të duken borë,
heshtja e natës të peshon si gur,
ka shkuar vonë:
ku-ku, ku-ku bën sahati në mur...
Ti sillesh nëpër dhomë,
fshin nga syri një lot të turbullt,
shtrihesh fillikat në çarçafët e ftohtë,
sirenat e largëta të ngjethin si kujë.
Këtij qyteti të madh që çlodhet,
dhimbja jote i sëmbon në trup...

P O Z V E R D H E N G J E T H E T N E P E R D R U R E

Po zverdhen gjethet e para nëpër drurë.
Ato bien mbi karriget e zbrazëta të parqeve,
 mbi rrugë,
 mbi supe kalimtarësh.

I mbledh këto gjethe dhe shkruaj në to
 lirikat e trishtë për vjeshtën,
këngët e fundme të zogjve
 që do të nisen për shtegtim.

Shkruaj èndrrat e vockla,
 brengosjet e kota,
 dashuritë e zverdhura,
që qenë më ditëshkurtra se jeta e gjetheve.
Shkruaj në to gjithçka të rëndomtë e të rrëme,
 kalimtare si këto ré bredharake
dhe ia jap erës t'i grisë pa mëshirë
 si letra të pluhurosura, të vjetra,
t'i shpérndajë andej-këndej
 si afishe shfaqjesh të harruara,
të luajë me to,
 t'i strukë nëpër guva,
 t'i zhytë nëpër pellgje. ..

I lë pas pa këqardhje dhe iki tutje,
 megjithëse qenë një pjesë e jetës sime,
siç qenë këto gjethe të zverdhura pjesë e drurëve.

MBRËMJE ME SHI NË TIRANE

Të lagura janë të gjitha rrugët e mbrëmjes,
të lara e të ndritshme
nga shiu i saporënë.

Dritat e makinave bien në ujë,
zgjaten tërthor si trarë të shumëngjyrshëm,
të gjitha rrugët i kanë zënë.

Ndalem e mbështetem pas një peme:
më duket sikur në vend të gjymtyrëve
sonte edhe unë kam rrënje!

Im bir në një qytet verior
tani me mua shëtit në ëndërr.

Midis trarëve të shumëngjyrshëm të dritave
rrëshqet malli im si një tren i vonuar...
Të lagura janë të gjitha rrugët e mbrëmjes.

KUAJT E KINOSTUDIOS

Gjithnjë marrin pjesë në beteja të inskenuara.

Nuk pikëlohen për të zotët e gjakosur,
për të zotët e vrarë:

gjakosja ose vrasja e tyre është truk.

Nuk u jepet rasti të përdorin mençurinë e tyre,
zotësinë për të kapërcyer një humnerë,
zhdërvjelltësinë për t'iu shmangur një topuzi.

Gjithçka që duhet të bëjnë
është përcaktuar në skenarin tekniko-regjisorial.

Nuk turfullojnë kurrë, nuk çukërmojnë kurrë
si kuajt e luftimeve reale.

Asnjëherë nuk i çojnë kalorësit e tyre
në takim me të dashura të vërteta.

Për ta s'do të krijohet asnjë baladë,
asnje këngë, asgjë legjendë...

Por me muskujt dhe fryshtën e tyre
ringjallen legjendat, baladat e hershme.

Kalëron koha, pavdekësia njerëzore
mbi trupat e tyre të bukur.

Tundin krifat në livadhin e rrethuar me tela,
vështrojnë përqark si fëmijë të hutuar.

Muzgjet me hënë
i shndërrojnë në statuja.

F O T O G R A F I A

Pesë shoqe shkolle, pesë lule të mbledhura tufë,
te sheshi «Skënderbej» po dilnin në fotografi.
Ato ia hodhën krahun njëra-tjetrës në mes, në sup
dhe mu atë çast prapa tyre ndodhi një çudi:
malet lëvizën nga vendi si në përralla,
mbi Malin e Gjerë harkuan kurmin pishat e Lurës,
Valbona dhe Vjosa u përqafuan me degët e kaltra,
palmat e Vlorës mbi pllajat e Shkëlzenit

u lëkundën.

Vajzat buzëqeshnin duke vështruar përballë
harqet që vizatonin mbi qytet krahët e pëllumbave,
renë që u tundte së largu një shami të bardhë...
Në sytë e tyre: Joni dhe Liqeni i Luleve.

FËMIJË TË PËRKËDHELUR

Të rinjve që kërkojnë
rrugë të lehta në jetë.

Ata janë mësuar që të vegjël
t'i thërrasin me ndajshtim,
pa emrin e tyre të përvëcëm:
i biri,

e bija e akëcilit.

Ata janë mësuar t'i hapin të gjitha dyert
si me një formulë magjike,
me fjalët e zakonshime:
i biri,

e bija e akëcilit.

Ata janë mësuar t'i fitojnë me lehtësi
notat, diplomën, vëndin e punës,
strehimin dhe plaçkat e shtëpisë...
Por sigurisht e kanë pasur vështirë,
më vështirë se të tjerët,
për të fituar gjëzimin.

Ata janë mësuar që të vegjël
të jenë hija e prindërve të tyre,
prandaj gjithë jetën do të mbeten pa emër,
të mbiquajtur me ndajshtimin svarues:
i biri,

e bija e akëcilit.

POETI VËNGËRASH

Ulet të shkruajë në tryezë:
në syrin e majtë rri redaktori,
në syrin e djathë kritiku.
Pas çdo vargu që shkruan,
pyet syrin e majtë:
A do t'i pëlqejë redaktorit?
Pas çdo vjershe që mbaron,
pyet syrin e djathë:
A do ta lëvdojë kritiku?
Shkruan mbi fletën e bardhë
dhe nuک e di si do t'i duket
vetes së tij.
Vë emrin poshtë vjershës,
si të vinte një pseudonim...
Ulet të shkruajë në tryezë
duke shikuar
herë me syrin e majtë,
herë me syrin e djathë.

DHE FRYN JUGA E BARDHË

Jakov Xoxës

Atje, diku afër Apollonit
a ndonjë perëndie tjetër të lashtë
është fytyra jote.

Pranë grunjërave dhe kullave të naftës,
atje ku çel lulja e kripës,
fytyra jote është.

Një rosë e egër fluturon nga kallamat,
klith sikur ty të thërret,
në ajër gdhend emrin tënd.

Gdhend profilin tënd të statujtë
me flokët e hapur në erë,
me atë buzëqeshje aq njerëzore —
dritë e Apollonit të lashtë...

Dhe fryn juga e bardhë.

1980

ORA PESË KA KALUAR QËKUR

Ora pesë ka kaluar qëkur.

Ajo ecën, ndalet, sheh orën, mbështet orën te veshi; pandeh se ora e saj ka mbetur që dje.

Tik-tak, tik-tak... Zemberekut lëviz, akrepat sillen, kalon ora shtatë, kalon ora shtatë e gjysmë: ora pesë ka kaluar qëkur.

Ajo ecën, ndalet, sheh orën, pandeh se ora e saj ecën përpara shumë shpejt, shikon orët e mëdha ndanë udhës: në të gjitha orët po shkon ora tetë...

Ora pesë ka kaluar qëkur.
Ai nuk do të vijë.

Mos u trishto, vajzë e bukur,

mos e mallko dashurinë.
Dashuria nuk ka ikur,
dashuria nuk ikën kurrë:
ajo mbetet në një kohë që nuk matet
nga akrepat e orëve.

1932-1933

K R U S H Q I

I bashkuan tryezat,
i bashkuan pranë tryezave kárriget,
i bashkuan pranë karrigeve këpucét e bardha,
 të hirta, të zeza,
I bashkuan bërrylat mbi mbulesat plastike
 të tryezave,
i bashkuan në taketuke hirin dhe bishtat
 e cigareve,
i bashkuan parfumet, pasthirrmat, fjalët,
 interesat,
më në fund i bashkuan duart e djalit e të vajzës
në sallën e kafes moderne...

Po zemrat?!

Zemrat e të sapofejuarve värtiteshin pértej
 xhamave
si dy flutura të verdha:
nxitonin, bënин zigzage,
por nuk e arrinin dot njëra-tjetrën.

M A S K A

Ata ecin të kapur për duarsh,
të kapur për qafe, për mesi...
Sikur janë xhelozë ndaj ajrit që i ndan,
shtrëngohen fort pas njëri-tjetrit.

Të rralla i kanë kostumet,
stolitë, parfumet që përdorin.
Në mimikën dhe lëvizjet e tyre
ka diçka prej aktori.

Shkrihen së qeshuri në rrugë,
fytyrën e zymtë e lënë te shtëpia...
U mungon vetëm diçka që s'blihet askund:
dashuria.

N È U R B A N

Një fëmijë me kapuç leshi të bardhë,
që më ngjan me një pëllumb,
shkruan në xhamin me avull të urbanit
fjalën «Kili»...

Urbani nxiton nëpër rrugë:
fjala «Kili» bie mbi shkronjat e reklamave
që spërkatin muzgun me stërkala të kuqe,
mbi njerëzit që ecin në trotuaret përballë,
mbi fytyrën e tejdukshme të një nuseje.

Avulli i ngrohur nga fryma e udhëtarëve,
nga vakësia që la te xhami gishti i fëmijës,
zë e shndërrohet në bulëza uji
që rrethojnë si pika loti fjalën «Kili».

Tani ky xham i zakonshëm urbani
është ekran i gjerë i botës:

aty shfaqen njerëz që ndeshen me policët e tanket,
që mbledhin shesheve shokët e gjakosur...

Duke parë fjalën «Kili» në xham,
sytë e udhëtarëve e humbasin shkëlqimin e butë
dhe ai fëmijë me kapuç leshi të bardhë
tani nuk më ngjan më me një pëllumb.

Fjala «Kili» në xhamin e urbanit

kullon bulëza uji sikur pikon dhimbje
në sytë e fëmijës, në sytë e udhëtarëve,
në hapësirat e kësaj mbrëmjeje dimri.

Dhjetor 1984

PEMËT NË DIMËR

Të përkulura mbi pellgjet e shirave,
dridhen e dridhen pemët e zhveshura...

Më tepër se nga era e dimrit,
ngjethen duke parë të pasqyruara në ujë
degët e tyre pa fruta, pa gjethe!

NJË MIKROBORGJEZI

Ti s'ke nxjerrë gjemba nga këmbët e zbathura,
s'je dridhur nga tē ftohtit nē fill tē këmishës,
s'ke qarë ndonjëherë pér bukë.

Ti di tē vishesh me sqimë,
tē flasësh pér Frojdin, pér Zhan-Pol Sartrin,
tē habitësh me lajka ndonjë çupë.

Megjithatë tèrë jetën do tē mbetesh
vetëm një njeri që konsumon
mish, pije, stofra, këpucë...

Ti do tē doje që unë tē isha vetëm bari,
tē ecja tanì nëpér pllajat e bjeshkëve
me kërrabë e me gunë
dhe emri im (emër malësori)
tē lagej nga shirat, tē rrihej nga era
vetëm i gdhendur me brisk mbi një trung
ose shumë-shumë tē përmendej nē gazetë:
akécili bari mori nga tufa e deleve
kaq kile lesh,
kaq litra qumësht.

Ti do tē doje që unë tē isha vetëm druvar,
tē tèrhiqja trupat me capinj,
tē ngarkoja makinat nē pyjet e Pukës,
pér t'u ngrohur ti nē dimër,
pér tē shkruar nē letrën e prodhuar me ta

vjersha belbacuke për dashnoret e tua...
Kür tî më shikon,
në sytë e tu skërmitet një ujk.
Unë mirë e di,
ai ujk është dhëmbërënë,
ai ujk është bishteub!

Lumi e di ku buron

DUHET TË BËHEM MË I RI

Në fëmijëri isha gjashtëdhjetë vjeç,
kisha moshën e tijerëzve që më rrethonin,
botën e shihja me sytë e tyre të turbullt,
brengat, rrudhat e tyre më uleshin në ballë.
Nën thonj kisha gjakun e zi të gishtave të tyre
 të vrarë nga gurët,
mendoja, ëndërroja si ata.

Në flokët e mi bashkë me gishtat e nënës
përdridheshin énde tymrat e luftës.
Duhmën e barutit nuhata në ajër,
pa thithur kundërmimin e lulekaçes, të kulprës.
Mora pjesë në betejat e gjyshërve, të etërve,
mësova emra gjeneralësh, shtetesh të largëta
më parë se të mësoja të gjithë emrat e fqinjëve,
të lëndinave e të kodrave të fshatit...

Duke u rritur, nisi të bëhesha më i ri.
Përtërihesha dita-ditës si njerëzit që më rrethonin,
sytë e tyre të turbullt bëheshin më të kthjellët,
me rrudhat e ballit të tyre lëshoja në qiell balona.
Tani gjaku përdorej vetëm pér të krijuar njerëz,

duart e tyre mbusheshin me grurë, me dritë.
Hemisferat e duarve të tyre që bashkoheshin,
krijonin një diell gëzimi pér vete, pér mua,
një diell dashurie pér botën.

Përtërihej bota rreth meje.

Kuptova se duke u përpjekur pér përtëritjen
e botës,
pa e vënë re njeriu rinon vetveten.
Po sot, ç'moshë duhet të kem sot?!...
Mendja ma thotë se jam njëzet vjeç.

Nesër,

e di, do të kem moshën e fëmijëve të ardhshëm,
botën do ta shoh me sytë e tyre,
do të mendoj, do të ëndërroj si ata.

Duhet të bëhem patjetër më i ri.

NJË RE E BARDHË

Një e re e bardhë përtej dritares
zgjatet mbi malin e mavijtë,
merr trajtën e një dore.

Kush po ma bën me dorë
prej së largu,
që nga fëmijëria ime?

Mos është dora e butë e gjyshes
që ka dëshirë të më prekë flokët,
të ma qetësojë zemrën e trazuar
si pëllëmba e një fëmije
që përkëdhel kurrizin e një pëllumbi?

O, ajo dorë e bardhë reje
po m'i sheshon rrudhat në ballë,
po m'i freskon qepallat e rënduara
e po m'i përtërin sytë e lodhur
si gjumë fëmijërie...

Ajo re e bardhë që vjen nga vendlindja

NGJITJA E SONDES SË PARË NË MALIN E HEKURAVE

Ata shkelin mbi këta gurë të ngrënë nga rrufetë,
nga erërat dhe thundrat e drenushave.

Një pëllëmbë poshtë këmbës së tyre
gremina gëlltit gurë në gurmazin e saj.

Një shqiponjë sillet mbi kreshtat e bjeshkëve,
në ijet e njerëzve mbijnë një palë flatra.

Ata kanë mbajtur mbi supe djepe, duaj gruri,
qengja të sykëm, pushkë, lodra dasme;
kanë mbajtur në duar kokën e të dashurës.

Dikush ka mbajtur, në kurriz shokun e plagosur,
duke u hequr zvarrë midis plumbave;

ka mbajtur qiellin që rrëzohej në sytë e të rënëve.
Tani mbajnë së bashku peshën e kësaj sonde,
peshën e qytezave, të uzinave të nesërme.

Ata shkelin mbi këta gurë të ngrënë nga rrufetë,
nga erërat dhe thundrat e drenushave:

Mali i Hekurave del nga miti i qëmotshëm.

Ata i kanë sytë dhe zemrën te maja.

Mbi supet e tyre ngjitet koha.

TESTAMENTI I SADRI ISUFIT

E ngushtë është gryka e Dragobisë,
ingushtë qelli mbi të,
të ngushta arat, rrugët midis tyre...
Këtu më të gjera se gjithçka
janë zemrat e njerëzve dhe odat e miqve.

Oda e miqve në kullën e Sadri Isufit
është pesë metra me katër e gjysmë.
Kulla e madhe i dukej e ftohtë dhe e varfër,
vetëm kur oda ishte pa miq.
Mbrëmjeve ndalte në rrugë udhëtarë të largët,
i merrte në kullën e tij...

Sadri Isufi u la bijve e nipave
këtë testament:

Mos ma ngushtonit odën e miqve!

Atjetë em si është emri rrethës së tij
është et

është si vëbrën shembull gjatë atij

ZOGJVE TË VENDLINDJES

Më falni, zogj që fluturoni mbi pjergullat
mbi pemët me degë të varura dhe arat me misër,
në fëmijëri ju kam gjuajtur me gurë...

Më besoni,
flatrat dhe cicërimat tuaja gjithnjë i kam dashur,
por e vogël ishte ara e misrit,
e rrethuar me mure, me gardh të lartë.
Në mes të arës lëkundëj një dordolec i hirtë,
që mbante në qafë një vargua me lëvozhga vezësh.
(Si ky dordolec e përfytyroja në èndërr urinë,
më ngjethte zhurma e vargoit në muzgjet me erë!)
Ju gardhin e lartë e kapërzënët sikur luanit
dhe dordoleci i frikshëm s'ju ngjallte më frikë:
mbi arën e vogël vërsuleshit tufa-tufa.
Çukisnit majat e kallinjve që kishin lidhur kokërr,
çukisnit bukën time, thërrimet që mblidhja në
tryezë,
çukisnit fytyrën time, duart e mia me gishta
të hollë.
Tërë ditën ruaja ndanë gardhit të lartë

t'ju trembja duke bërtitur, duke ju gjuajtur
me gurë...

Zogj të vegjël,
ju s'donit t'ia dinit nga gurët, as nga britmat.
(Madje as nga peri i zi, i fshehur në mur,
me të cilin ju lidhte gjyshi Natën e të Lidhurave!)
Iknit nga një cep i arës, turreshit te cepi tjetër,
sikur talleshit me mua
dhe me dordolecin që e tundte era...

Zogj të bukur të vendlindjes,
disa breza zogjsh keni çelur në çerdhet tuaja
dhe unë, siç e shihni, tani s'jam më fëmijë.
Ju fluturoni pa druajtje mbi pjergullat me rrush,
mbi pemët me degë të varura dhe arat me misër.
Tani arat s'kanë më gjerdhe, as dordolecë.
Cicéroni,
fluturoni nga të doni, zogj të vegjël!

I M A T È

S'e kam përqafuar asnøjherë,
s'ia mbaj mend fytyrën, tingëllimin e zërit.

Fqinjët më thanë: *Ka qenë si tambli i deles.*
Gjyshja më tha: *Nuk némte kurrë.*

Nëna më tha: *Edhe po të ectë gjithë ditën nëpër shi,
një pikël balte nuk i ngjitej në petka.*

Fqinjët më thanë: *Ka qenë njeri i besës.*

Gjyshja më tha: *Para se të vdiste, mbolli të gjitha
arat.*

Nëna më tha: *Nuk na la të bluanim asnje kokërr
farë,*

*Megjithëse punonim duke ngrënë vetëm lëpjeta.
(Ishte kohë e vështirë: viti 1947.)*

Fqinjët më thanë: *Iu thye nën këmbë një degë
qershië,
nga hidhërimi shoku i tij e preu atë qershi
në rrënjjë.*

Gjyshja më tha: *Ai erdhi në bjeshkë e kërkoi
vetëm borë.*

Nëna më tha: *Ai vdiq në verë...*

Im atë më vështronë nga sytë e pikëlluar të
gjyshes,
merrte frymë me ofshamat e thella të nënës,

KULTA KU KAM LINDI
ia dëgjoja zërin në fjalët e mira të fqinjëve,
ia prekja duart te çakmaku i tij, gitek abetarja
e futur në një arkë,
ia shihja gjurmët e këmbëve kur u jitja misrat.
S'e kam përqafuar asn jëherë,
s'ia mbaj mend fytyrën, tingëllimin e zërit:
po a mund të thëm se kam qenë
pa baba për të më mësuar,
a mund të them se im atë ka vdekur?

Hënës s'është veshur me shëng e blloq
madrabotë s'është veshur me shëng e blloq

me shëng e blloq s'është veshur me shëng e blloq

me shëng e blloq s'është veshur me shëng e blloq

KULLA KU KAM LINDUR

Kulla ku kam lindur një ditë dimri
(gurët e saj janë në muret e shtëpisë së re)
shpeshherë del natën nga themellet e dikurshme
si një floçkë që shkridhet nga uji i liqenit.

Ajo vjen prej së largu, më gjen kudo që ndodhem,
tkurret, zvogëlohet e futet në qenien time.

Krismat e pushkëve ushtojnë nëpër kthinat e saj,
plakat me të zeza murmuritin kokë në kokë.
Ninullat e nuseve, përrallat, tingujt e lahutës
si folë dallëndyshesh varen në kungët e heshtura.
Fërfllaza fishkëllin, lëviz rrasat ngjyrë hiri,
ujqit e uritur ulërijnë në oborrin me borë
me një hënë tëngrënë e të akullt midis dhëmbëve.
Një degë e lulëzuar molle zgjatet te dritarja
ku më presin flutura të larne sa pëllëmbët

e mia...

Kulla e gurtë ku kam lindur një ditë dimri,
vjen prej së largu, më gjen kudo që ndodhem,
çlodhet brenda meje si shtegtar i kapitur.

NË LIVADHET E VERËS

Fli në livadhet e verës, fli!
Hëna i mbushi shtrungat e luginave me qumësht,
yjtë i zuri gjumi në sytë e deleve, në qerpikët
e barinjve, bjeshkët i mbyllën në guva ulërimat e ujqve,
përroi përtëj tëbanës murmurit një ninullë
të pasosur, të bëhesh prapë shpend nëpër èndrra si dikur...

Fli në livadhet e verës, fli!

Kur të zgjohesh, rrëth teje do të kenë çelur
shebojat, degët e rënduara me dredhëza do të përkulen
mbi ty, dielli do të mbështetet mbi fytyrën tënde si gji
nëne ku do të pish, do të pish e s'do të ngihesh kurrë,
ylberi do të prekë nën mjekër e ti do të shkrihesh
së qeshuri, do të ndiesh në gojë shijen e fjalëve
të sapomësuara, pranë teje do të këndoja ai zogu i përrallës

që i di të gjitha të fshehtat e të gjitha këngët,
era do të sjellë një kalë përmes jorbsvil është
në pyje do të gjesh pshërëtimat që tashmë i ka
burimet do të ta kthejnë ftyrën tënde fëmijërore
e ti do të besosh prapë te zanat si dikur...
Fli në livadhet e verës, fli!
Nesër do të zgjohesh si fëmija që nxiton pas
që ka në gojë shije qumështi e dredhëzash
që ende s'di q'janë dhimbjet, e keqja, zhgënjimi —
për itënjeta është ende një kohë që nuk matet.

КОХА Е DINJITETIT

Një malësori që kishte banuar
në një kasolle të mbuluar me baltë,
pa asnje dritare për të hyrë drita e diellit,
me një derë të vetme për njerëzit e bagëtitë,
i dhuroi shteti një shtëpi të re.

Fqinji i tij që deshi ta ngacmonte,
i tha se kasollja me baltë do të ruhej si muzé.

Malësori ndjeu në damarë një gjëmim të mytur,
iu tërhzën rrudhat e thella te balli.

Me të rënë muzgu,
mori kazmë e lopatë, doli pa folur me asnjeri
dhe shkoi te kasollja e mbuluar me baltë...

Në agim nga kasollja nuk mbeti gur mbi gur.

Ai i kishte duart të gërvishtura, të përgjakura,
por në sytë e tij që qeshnin
kishin vesuar tërë yjet e asaj nate!

NË HIJEN E PEMËS

Edhe kur tē mos jem më
do tē ketë re tē bardha në qiel,
do tē cicerojnë tē gëzuar zogjtë,
do tē luajnë tē shkujdesur fëmijët
dhe njeriu që ka punuar në arë
do tē çlodhet në hijen e pemës,
mbase këtu ku jam ulur unë,
do tē vështrojë retë e bardha në qiel,
që s'do tē jenë më këto re,
do tē mendojë për shiun
dhe për bukurinë e tē jetuarit.

SHPYLLËZIMI I PYLLIT TË PRITAVE

Pylli nuk është më. Vetëm vegimi i tij
i zhurmëron në kujtesë. Trungje të mëdha.
Hije të errëta. Fieraja. Ulërima ujqish.
Zogj nate që klithin dhe kërkojnë një degë
ku të ulen. Bisha që presin në përgjim
prenë e tyre. Sy të kuq gjakësish
të struktur midis gëmushave. Mbajtja e frymës.
Térheqja e këmbëzës krrak si
krakërimë korbi mbi kafkë. Rrëzimi
i rëndë i të vrarit mbi barin e përgjakur.
Rendja e ndërkryer e gjakësit,
duke u përplasur e fshehur prapa trungjeve.
Përgjimi. Dihatja e rëndë. Tharja
e pështymës. Prapë vrap i trallisur. Ikja
e zogjve. Ikja e bishave. Ikja e hënës
përmes drurëve, si fytyra e të vrarit.
Plandosja përtokë si i vdekur. Gjumi.
Mbulimi i qenies së tij nga një luzmë
ëndrrash të liga si një turmë kandrrash brejtëse
që mbulojnë të vdekurin... Por pylli
nuk është më. Vetëm vegimi i tij luhatet
në kujtesën e plakut. Vetëm cungje të moçme,
të kalbura... Dhe në pafundësi: fusha.
Gruri. Pemët. Shtëpitë me dritare të gjera.

AJTAJU S'ESTE M'ESTE

Plaku ndien marramenth. Dhe pylli ulerin
në kujtesë! por pylli më errësirë e pritë
s'është më... Dhe fusha, pemë, shtëpi
me dritare të gjera. Dhe drita, drita, drita!

Dhe drita, drita, drita!
Dhe drita, drita, drita!
Dhe drita, drita, drita!
Dhe drita, drita, drita!
Dhe drita, drita, drita!
Dhe drita, drita, drita!
Dhe drita, drita, drita!
Dhe drita, drita, drita!
Dhe drita, drita, drita!
Dhe drita, drita, drita!
Dhe drita, drita, drita!

MBRËMJE KORRJESH

Mëllenja klith nëpër shkurre,
përsërit një fjalë të vetme:
korr-korr-korr!...

Zérat e korrësve që vijnë nga fusha,
era i shpërndan si drithë të shkoqur.

LEJLEKU I FËMIJËRISË

Kaloi bjeshkët një lejlek...
Pareshtur fluturon drejt meje
 ai lejlek me krahun e plagosur,
 me pendët e bardha, të përgjakura,
me sqepin e gjatë që ngulej në fushë
 në fund të një ligjërimi tragjik:
O, ata m'i vranë fluturimet e mia të nesërme,
udhëtimet e mëdha mbi male dhe dete,
 gëzimin e kthimit në vendlindje
krah për krah me retë e bardha, me erërat
 e ngrohta
që sjellin pranverën nën squetullat e tyre!...

Blegërinin shqerrat rrëth lejlekut të përgjakur,
e kuptova se njeriu mund të qajë
 edhe për një zog,
për fluturimet e tij të vrara, për çerdhen e tij
 të shkretë.
Ai lejlek me krah të plagosur
 pareshtur fluturon nëpër ditët e mia
 dhe më mëson të urej.

ÇUNAKUT ME GJUNJË TË PËRGJAKUR

M'i more gjërat më të çmuara që pata,
habinë, të panjohurat e shumta,
qashterinë, përrallat, cinglat,
ëndërrimet dhe dëshirat e marra.

Më more gjumin eëmbël,
ditët pa dhimbje koke, pa dhimbje në kryqe,
trillet që s'i kuptionin të mëdhenjtë.
Më more një trastë të madhe me vite,
e fshehe diku nën një rrasë
në Shpellën e Orëve
ku thonë se nuk shkel këmbë të gjalli...
Megjithëse ke ikur prej kohësh,
nuk harron të vish herë pas here,
të më sjellësh me vete kujtime
si rruaza të shumëngjyrshme qelqi.
Në ardhsh një ditë tek unë
e n'e gjetshë derën të myllur,
atë ditë do të kem vdekur!

MALI MË THËRRET

Në çdo orë të ditës
një mal do të më dalë përballë,
një mal do të më thërrasë.

Do të më thotë fjalë pa zë
që vetëm ne të dy i marrim vesh.
Do t'i them mendime që s'a kam shprehur
askujt,
që vetëm ai mund t'i kuptojë
dhe mund t'i ruajë vetëm ai.

Në çdo ditë të jetës,
sapo të hap një dritare,
sapo të dal në rrugë,
sapo të gjendem në një fushë të hapur
apo në një breg deti,
do të sillem rreth vetes
duke kërkuar me sy një mal.

Në mos pastë mal asgjékundi,
do ta trilloj me përfytyrimin tim.

Edhe në çastin e fundit të jetës
do të ngrihem pakëz në bërryle,
do të vështroj njerëzit e mbledhur rrëth meje,
do t'u lutem të hapin dritaret,
mandej do t'i ngrë qepallat me mundim
për të vështruar në largësi,
për të kërkuar me sy një mal.

Në regëtimat e mbrame të vetëdijës
do të dëgjoj zërin e largët
të një mali që më thërrret...

Këtë do mësojëm që më 1919-të

Bari nën gur

NJERIU I BURGOSUR PËR NJË KËNGË TRIMËRIE

Diku, në botë vritet kënga

Tani jam mësuar me këtë gardh hekurash,
që e shoh përditë nga dritarja ime.

Jam mësuar me shumëkëmbëshat që vrapojnë
nëpër mure,
me fluturat që sillen rrith meje, me brumbujt
e zinj.

Jam mësuar me të lehurat e qenve
që kafshojnë egërsisht heshtjen e natës,
me kukuvajkën që ulërin diku në strehë:
nganjëherë më duket sikur fshihet në veshin tim.

Jam mësuar me merimangën memece,
që ka thurur një cfagë te këndi pranë shtratit,
sikur pret të përpëlitet koka ime në të...

Veç s'po mësohem dot me këtë dreq bulkthi,
që më kujton fshatin tim dhe arat buzë lumit.
Nuk po mësohem dot me këtë heshtje,
ku mungojnë hapat e gruas dhe zërat e fëmijëve.
Nuk po mësohem kurrsesi me këto duar

të zbrazëta,
që i mbushja me dhé të shkrifët, me kokrra gruri
e mollë,
me duar shokësh, me sharkinë e vjetër, me erën
e maleve...
Kurre nuk do të mësohem të jetoj pa këngët e mia.

KATËRKËNDËSHI I ZI

Pinoçetit dhe diktatorëve si ai

Vër në kokë helmeta,
vër kurora dafinash,
kurora floriri,
fshihu "prapa dyersh e gardash të hekurta:
prapë do të futesh

brenda katërkëndëshit të zi.

Ha ditën,
ha natën,
derisa trupi yt të marrë trajtë sferike,
shumëfishoje veten në shtatore të larta:
prapë do të futesh

brenda katërkëndëshit të zi.

Tryeza ku sodit fitimet përrallore,
dera ku hyn e del çdo ditë,
ekrani ku jep intervista,
kanë formën e katërkëndëshit të zi.

Më afér se lëkurën tênde,
se ajrin që thith në mushkéri,
më afér se brinjët
rreth mushkérive e zemrës,
i ke brinjët e katërkëndëshit të zi.

Katërkëndëshi i zi po të pret,
prej kohësh ka filluar
të të brejë çika-çika:
çdo natë kur shtrihesh për të fjetur,
mbyllesh brenda katërkëndëshit të zi.

Do të vijë një ditë
që s'do të dalësh më
nga katër brinjët e tij të mbyllura
me një dry të rëndë heshtjeje,
që s'do ta çkyçë më zëri yt.

Ngado të rrethojnë grushtet dhe plumbat,
të pret ndëshkim i pamëshirshëm!

BARI NËN GUR

Ti je nën gur,

megjithatë je bar.

Tërë kohën të mbështjell ngjyra e verdhë.

Ngjyra e gjelbër,
ëndrra jote e papërmbushur.

Midis teje dhe diellit —
ai gur i rëndë.

Me gur mbi trup,
ëndërron diellin që s'e ke.

I mbështjellë me ngjyrë të verdhë,
përpiqesh të arrish
diellin që s'e ke.

Gurin e shtyn me trupin tënd,
i etur për diell.

Bari
edhe gurin e çan!

PROMETEÙ DHE ORLI

Një revolucionari të martirizuar

Gjithmonë ka pasur Prometenj e orla,
sic ka pasur perëndi dhe shkëmbinj:
Prometeu s'mund të rrijë pa sfiduar zotat,
Orli ka lakmi për mëlçi njeriu.

Prometeu vështron hapësirat e largëta,
i mbërthyer me shpatulla në shkëmbinj:
edhe po ta zgjidhnin perënditë nga prangat,
ai do t'ua vidhte zjarrin përsëri.

Orli vërsulet me klithma nga qielli
dhe ia shqyen kraharorin me çaponj:
pikërisht kjo dhimbje s'do ta lërë Prometeun
t'i shkojë në mendje për t'u bërë zot.

Çasti më sublim në jetën e tij
dhe ndoshta më i madhi triumf
është kur orli ikën, pikon gjak mbi shkëmbinj
dhe ai murmurit: Perëndi, ju përbuz!

SKËNDERBEUT

Ende dikush diku po luftoka kundër teje.

Të vdekurit i lënë të qetë, vetëm të gjallët
kanë armiq.
Ka pesëqind vjet dhe énde s'ke nisur të vdesësh,
énde s'ke pushuar së linduri,
énde s'e ke lëshuar shpatën nga dora.

Ende të tingëlloka emri dhe shpata liri.

Kurrë mos mbetsh pa armiq,
derisa të ketë armiq të lirisë!

MALLKIMI I SHKËMBIT

Mos ma merrni këtë dhé,
rrëké që rridhni me rrëmbim,
erëra që fryni me tërbim.

Lërmani këtë grusht dhé,
të mbijë në të një dorë bar,
një kérçell luleje, një rrënje gjineshtre...

Mallkuar qofshi,
vjedhëse të pamëshirshme,
që ma grabitët grimcën e mbrame të dheut
nëpër plasat e mia!

Mallkuar qofshi,
që më latë të zhvëshur,
pa stinë!

Tash a do të mundem të shoh më
ëndrra gjelbërimi?

G J A R P R I

Dita i kalon kafené më kafené
duke zbzazur gotat me piye,
duke mbushur veshët me fjalë të vjedhura.

Sytë e tij — sy gjarpri në bar.

Rrëshqet rrugëve si hije,
natën kruspusulloset në krevat,
cingërima i futet në eshtra.

Si një dërë me menteshal të ndryshkura,
që përplaset pareshtur nga era,
në qenien e tij gërvin frika.

Nga èndrrat plot ftyra të vrarësh,
zgjohet me sy të skuqur, të enjtur.

Gjarpëron midis kalimtarëve,
me një skërmijje ujku ndër dhëmbë,
duke menduar: *Cilit do t'i ha kokën sot?*

Murmuritin nuset me të zeza,
plakat që ujtin karafilat në ballkone:

Gjarpër i zi, të humbtë emri!

M E R G I M T A R I

Vë përpara një letër të bardhë,
heq vija me laps dhëben muret e një shtëpie,
i vë shtëpisë një çati të pjerrët pér të shkarë bora,
vizaton dyert, dritaret, shkallët, oborrin,
në oborr vizaton plepin ku ndodhet emri i tij...
E lë lapsin në tryezë, mbështet kokën në pëllëmbë,
duke vështruar shtëpinë e sapovizatuar,
ngjit me mend shkallët, troket në derë.
Te dera e hapur shfaqen fëmijët,
i hidhen në qafë, kacavaren pas tij,
mbyllin derën të mos futet brenda të ftohtit.
Ai heq pallton, këpucët e qullura nga shiu,
ngrohet pranë stufës ku zien ibriku i çajit,
qëron një mollë dhe ia jep së bijës,
më vonë dëgjon të birin t'i flasë pér dardaniët,
e ndihmon të zgjidhë një problemë me trena...
Nata e ftohtë rrëqethet nga fishkëllimat e trénave:
asnjë nga këta trena s'do ta çojë në vendlindje.
Gishtat i dhembin duke shtrënguar lapsin,
heq dy vija që priten mbi shtëpinë e vizatuar,
vë një kryq mbi iluzionin e tij.

SHQETËSIMI I BERTOLT BREHTIT

Duke ecur rrugës, Bertolt Brehti dëgjoi këto fjalë:
«Jam pa shtëpi... Rrimë në hotel... Gruaja pret të
lindë...»

Brehti e la shëtitjen në mes, u kthyte te vila
e madhe,
ku banonte me librat, personazhet dhe fantazitë
e tij.

Dhomat i dukeshin si kabinet e një anijeje
të fundosur.

Ra vonë në shtrat. S'e zuri gjumi. Nga dhomat
fqinje
oshëtinin hapa të rëndë, të zvargur, monotonë:
ishin hapat e tij të mbetur udhëve të mërgimit.
Në mëngjes u afroa te pasqyra e madhe e sallonit,
ku u shfaq fytyra e ish-pronarit që i shkeli syrin...

Bertolt Brehti e la vilën e bukur më shumë dhoma:
aty hynë ai që jetonte në hotel me gruan shtatzënë,
disa familje punëtorësh që s'kishin shtëpi.

Brehti mori një hyrje në një pallat të zakonshëm.
Tash ai mund ta conte deri në fund shëtitjen
e mbrëmjes.

mund të mendonte e të ëndërronte i qetë,
mund të ulej në tryezë e të shkruante
për njerëzit.

DËSHTIMI I MILINGONAVE

Për pacifistët

Kuvendi i milingonave mori një vendim
të bujshëm:
të shmangonte rrezikun e luftës, të hiqte qafe
luftënxitësit;
prej mijëra vjetësh njerëzit s'po ia dilnin mbanë
kësaj pune...
Lajmëtarët lëshuan kushtimin në të katër anët e
rruzullimit.
Milingonat dolën nga plasat e gurëve, nga foletë
prej balte,
nga zgavrat e trungjeve të vjetra, nga bodrumet
me lagështirë,
formuan varganë të mëdhenj që ecnin pa pushuar
ditë e natë.
Ato hynë në pallatet qeveritare, në laboratorët
e mbikëqyrur,
rrethuan politikanët dhe atomistët që shpiknin
armë të reja,
i mbështollën si trupin e një gjarpri të plagosur
në pyll,
ua brejtën lëkurën e mishin, derisa mbetën vetëm
skelet...

Milingonat panë se këto skeletet vazhdonin
të cirreshin për luftë,
të jepnin urdhra për agresione, të prodhonin armë
të tmerrshme.

Një milingonë më e mençme tha se kishin harruar
trutë.
Milingonat u derdhën prapë me mllef mbi skeletet
e brejtura,
gllabëruan palcën e shtyllës kurrizore, trutë e
fshehurë në kafkë.
Për çudi, skeletet vazhdonin të cirreshin për
luftëra të reja,
të prodhonin armë më të tmerrshme se më parë...
Të dëshpëruara, milingonat u kthyen në vendlindjet
e tyre.
Ato nuk mund ta shpëtonin planetin tonë:
vetëm popujt do të shpëtonin vetveten,
do të shpëtonin qytetet, pyjet, barin, zogjtë e
milingonat.

Koha që nuk matet

KOHA BANON NË BALLIN TIM

U kacavar tek ylberi:
Vjega e tij u këput.

U ul mbi pemë:
gjethet e degët u thanë.

Pushoi mbi gur:
s'e mbajti e u thye.

U vesh me parzmore çeliku:
i breu ndryshku.

U mbyll në kështjella:
muret e tyre u rroposën.

U struk në eshtra fjalësh:
dhjetëra fjalë vdiqën udhës...

Koha banon në ballin tim:
nuk gjeti shtëpi më të mirë.

XHOKAT E ZEZA

IMISEK

Për vdekjen e Skënderbeut,
për humbjen e lirisë,
të gjitha xhokat populli i ngjeu të zeza...

Zia qëndronte mbi shpatullat e njerëzve,
që harresa dhe gjëzimi i pandershëm
të mos u futej në shpirt.

Te palat e xhokave të zeza
ishte imazhi i flatrave të shqipes.

N E Z I M I

Në hije të selvive ka rënë në mendime Nezimi,
era që fryn nga lumi, luan me leshrat e bardha.
Në sy i fluturojnë gjashtë pëllumbë që dikush
i trembi:
mos i trembën troket e shpurës së sundimtarit,
britmat e ngjirura, vringëllimat e jataganëve
të huaj,
apo daullja që lajméronte varjen
e një kryengritësi?...
Era merr me vete troke kuajsh, vringëllima
jataganësh,
pëllumbat ulen prapë mbi pullazet e pjerrëta.
Frym erë manushaqesh nga kopshtet e prillit,
frym erë trëndafili nga kraharorët e vashave.
Në vargjet e Nezimit mbijnë fjalët e lashta
të etërve
si fije të blerta bari midis gurëve të hirtë.

FOTIOLA

(Emri i një vajze ilire mbi një pllakë varri
në muzeun e Beratit)

Paske dy mijë vjet që më pret?!

Ja ku erdha, pra.

Shtyje këtë pllakë varri dhe çohu,
eja të ecim dorë për dorë në rrugët e këtij qyteti,
hapi në erë flokët e tu që kundërmojnë borzilok,
Po deshe ti, do të puthemi.
Po deshe ti, do të martohemi, do të bëjmë fëmijë
dhe njërit prej tyre do t'i vëmë emrin Tomor...

Ti shtyn pllakën e mermertë e ngrihesh,
shkund në vend të pluhurit dy mijë vjet,
dy mijë luftëra shkund nga supet e brishta.
Ne ecim së bashku te kjo kështjellë, Fotiola,
të qeshurat e tua kumbojnë në mëngjesin

e ikthjellët,
i drithërojnë muret e kafshuara prej gjyleve...

O, ti paske fytyrën dhe zërin e së dashurës sime!

E DIEL BERATASE

Në tregun e lashtë të qytetit
lëvizin burra me shajak e fytyra të strallta,
që kundërmojnë ajkë, lëng hardhie, shqopa
të djegura,
fusharakë e qytetarë me veshje më të holla.
Pranë tyre fektojnë vashat e reja,
me trup të brishtë, të zhdërvjellët si vetëtima.
Ata përshëndeten, qeshin, bien në mendime,
flasin për të mbjellat, pér ditët e dasmave,
pér ortekët e borës që kanë rënë në veri,
pér luftën që nxjerr tym në një vend të largët...
Të duket sikur kanë mijëra vjet që rrinë aty,
duke vazhduar të njëjtat biseda: të përjetshëm
si toka që kanë nën këmbë, si dielli në qiell.
I dehur nga kjo dritënajë që të rrethon ngado,
që buron nga rrezet, nga gurët e bardhë,
këtu ndien një afërsi të çuditshme me kohërat
si ky qytet që mbështetet te lashtësia dhe
e ardhmja.
Koha e tij kanë qenë dhe janë këta njerëz
që lëvizin, flasin e qeshin mbi kalldrëmet e lashta.

LUFTËTARI KOMBËTAR NË KORÇË

Bora zuri në mesnatë.

Atij iu zbardhën flokët, shpatullat, palat e llabanes
dhe faqja e djathjtë që ia rrihte era:

Ai zbriti nga piedestali, kapërceu gryka malesh,
u ndal te një shtëpi e gurtë, trokiti në derë,
e ëma e shtrëngoi me ngashërim pas gjirit.

Kapërceu male të tjera. Shtinë mbi të. Ai râ.

Bora u përgjak nën brinjët e tij.

Fijet e barit u gjallëruan për ta mbajtur në krahë;
ai u ngrit me një shqiponjë gjaku në këmishë.

Prapë e qëlluan në kraharor, në shpatulla.

Binte borë. Tani ai ecte nëpër kohë...

Njerëzit hapën dyert dhe dolën në rrugë:
ai qëndronte në piedestal, i zbardhur nga bora

si i mbështjellë me legjendë.

Ai hyri në sytë e njerëzve bashkë me mëngjesinat

FLUTURA KRAHËBARDHË

Mësonjëtores së Parë Shqipe

E kam ndjekur nëpër kohë këtë flutur krahëbardhë,
këtë flutur krahëshkruar:
Oii, sytë e mi për të janë djegur
e fjalët e mia për të janë shkrumbuar!
Sa kam zgjatur krahët për ta marrë në pëllëmbë,
erërat e furishme me mllef ma kanë larguar...
Një ditë marsi erërat i ka zmbrapsur,
në kraharorin e gurtë të këtij qyteti është ulur;
nga plagët e mia lulëkuqe kanë dalë
e fjalët e mia të lashta kanë luluar!
Deri në qiell korbat për kob kanë klithur
e merimangat bizantine cfaga kanë thurur
për ta mbytur këtë flutur krahëbardhë,
këtë flutur krahëshkruar.
Qerpikët e fëmijëve janë bërë ushta
 për ta mbrojtur,
me flatra të përgjakura shqiponjat e kanë rrrethuar.
Gjuha e nëmur e korbane është tharë,
merimangat në cfagën e tyre kanë mbaruar...
Horizontin tim e ka zdritur kjo flutur krahëbardhë,
kjo flutur krahëshkruar,

Korçë, shkurt 1987

NË BREG TË DETIT FRYN JUGA

Në breg të detit fryn juga,
më ushtojnë daullet e veshëve.
Cilat hordhi po vijnë nga larg?
Cilat gjuhë po shtyjnë njëra-tjetren,
për të ma rrëmbyer ajrin e mushkërive?
Përplasen heshtat e shpatat,
ndeshen zanoret e bashkëtingëlloret,
kryqet, gjysmëhënati, stemat e monarkëve,
efizhitë e anijeve, të monedhave...
Në breg të detit fryn juga,
më ushtojnë daullet e veshëve.
Cili gjeneral u ra borive në ag?
Cili perandor u thyte në mesditë?
Cilat qerre u fundosën baltrave?
Cilat anije u mbytën në gji?
Cilat ushtri u tretën nëpër natë?...
Në brigje ndërrohen leshterikët,
ndërrohen retë dhe erërat në qiell,
ndërrohen në dhëmbë dhe qiellza pushtuesish
tingujt e emrit të qytetit tim.
Në breg të detit fryn juga,
më ushtojnë daullet e veshëve.
Ka mijëra vjet që shkel te kjo rërë,
që shoh lojën e valëve, të pulëbardhave

dhe këtë qytet e quaj Durrës.
Askush s'ka mundur të ma ndalë ecjen,
të ma rrëmbejë ajrin e mushkërive
që e ruaj për zanoret dhe bashkëtingëlloret e mia,
për t'u dhënë frymë fjalëve të mia të lashta
Det, Diell, Mal, Besë, Gur,
për të thirrur në kupë të qiellit: I lirë!...
Në breg të detit fryn juga.

TRIMAT QË RANË NË DET

Të gjitha i kanë në det: gjakun, eshtrat, vdekjen.
Te koka e tyre në vend të gurit është ngulur
një pinë.

Algat kalojnë sipër tyre të lehta e të buta
si duar nëne. Rrezet e diellit që futen përmes ujit,
janë flokët e të dashurave që ua merrte era.

Të gjitha i kanë në det... Vetëm emri i tyre është
te toka,
ku dallgët gjëmojnë e kacavaren si malli i tyre.
Në tokë është pavdekësia e tyre, është kënga
që era e sjell te degët e ullinjve e të dafinave
në të gjitha stinët e motit...

S'është zëri i erës që oshëtin së largu:
zëri i tyre vjen te ne nga thellësítë e ujërave.

DETARI PLAK

Përballë tij është deti — miku i tij më i mirë.
Mbi kraharorin e regjur nga kripa dhe rrezet,
që e rrähën erërat e ngushticave, të gjireve
 të botës,
është vizatuar një shqiponjë me dy krerë.
Në sytë e tij të kaltër në të hirtë
lëvizin pareshtur pulëbardhat, anijet që lundrojnë...
Përballë tij është deti — miku i tij më i mirë.
Ohu, sa rreziqe dhe gjëzime kanë njojur së bashku,
kur zemra i brofte si peshqit që hidhen mbi ujë!
Detari plak rri me orë të tëra te shkëmbinjtë
si një shqiponjë e moshuar që ulet mbi kreshta,
për të ndier gjëzimin e lartësisë...
Deti — miku i tij më i mirë — për ta përshëndetur,
ngre shkulma që përplasen, thërrmohen pas
 shkëmbit
dhe hedhin stërkala te kömbët e tij.

TË LUTEM, KOLOMB, VAZHDOJE UDHËTIMIN TËND!...

Të lutem, Kolomb, vazhdoje udhëtimin tënd,
përku lu i shqetësuar mbi harta, fërgëlllo
si gjilpëra magnetike e busullës.
Lëkundu midis dëshpërimit e shpresës si anija
që përpëlitet midis dallgëve të oqeanit.
Vështroje horizontin me ngulm. Mbushi faqet
e ditarit
me dyshimet dhe ankthin e thellë.
Mendo çdo ditë për vdekjen, èndërrro
çdo natë për triumfin.
Hidhi të vdekurit në det që t'i hanë peshkaqenët.
Harroji barin e zogjtë. Harroji rrëketë
që gurgullojnë në shpatet e malit.
Harroje tokën e fortë ku mbështeten rrënjet
e pemëve
dhe këmbët e hijshme të valltareve.
Mbylli veshët të mos dëgjosh rënkin e oqeanit,
britmat e shokëve që të luten të kthehesh.
Mbaji sytë hapur edhe kur fle, që të shpëtosh
nga thikat dhe plumbat e komplotistëve.
Përfytyro vise përrallore, male me ar, qytete safiri.
Përfytyro që je zbulues i një hapësire më të madhe
se perandoritë e lashta.

Përfytyro ç'të duash, Kolomb, por mbylli veshët
të mos dëgjosh thirrjen: «Tokë!.. Tokë!...»
Me këtë thirrje merr fund lundrimi yt. Tani
s'do të jesh më detar: do të jesh skllav.
Jep urdhër të ngrenë spirancën. Mos zbrit
nëpër shkallët e anijes:
Ti nuk po zbret në breg, por në burgun tënd.
Vargonjtë e spirancës do të shndërrohen
në kurora mbretërore, në shufra floriri, në pranga...
O, ti vure këmbën në breg dhe pushove së qeni
Kolomb!

BABAI I POETIT

1

E zvordhi nga gjiri tokë e tij,
nëntokë e huaj ia kërrusi supet.

Gjakun ia pinë
Orlat e gurëve.

Gérreu mushkérítë e zeza të dheut
për padronët.

Në shpellat e mushkërive të tij
shtjella pluhuri ngrinte kolla...

2

U gropos kohë e nëmur,
kësaj toke të vuajtur iu mbush gjiri.

DABAI I POETIT

Me metalin që nxorën duart e babait,
u shtypën poemat e të birit.

Një pluhur guri, i largët
vjen e bie mbi germa.

Buçasin herë-herë kollitjet e babait
në hapësirat e poemave!

PARTIZANI I PAMPOSHTUR

Partizanin e torturuar e çuan në mes të lëndinës
me duar të lidhura pas shpine.

Ata e rrethuan me gurë deri në brez:
ai prapë nuk foli.

Ata e rrethuan me gurë deri në kraharon:
nga buzët e kafshuara doli vetëm gjak.

Ata e rrethuan me gurë deri në mjekër:
ai vështroi diellin, para se t'ia zinin sytë me gurë.
Kur u matën t'i vinin përsipër gurë të tjerë,
ata vunë re se gurët po mbështilleshin rrëth tij,
po bëheshin lëkurë, mish, eshtra, kraharon, sy...

Ata u zmbrapsën të tmerruar nga vështrimi
i partizanit,
që zuri të ecte nëpër barin dhe lulet e lëndinës.

Ata ikën duke u rrëzuar e duke gulçuar
si një bishë e plagosur...

Ata vazhdojnë të ikin edhe sot
në hapësirën e hirtë të një kohe që nuk matet.
Partizani i mbështjellë nga gurët e tokës së tij
ecën nëpër barin dhe lulet e lëndinës.

KUR TË KALOSH PYLLIT NË VJESHTË

Kur të kalosh pyllit në vjeshtë,
ndalu t'i shikosh shqemet e kuqërruara,
sikur kanë pikëluar mbi gjethe pika gjaku
të djaloshit që kishte moshën tënde,
që kishte gdhendur me brisk emrin mbi trungje.
Ai ra këtu nga plumbat e huaj
për emrin e kësaj toke dhe për ty...
Të thashë: ndalu t'i shikosh shqemet e kuqe,
sikur kanë pikëluar mbi gjethe pika gjaku.
Ti do ta kesh në sy kuqëlimin e tyre
deri në mbrëmje, ndoshta dhe më tepër
e do ta ndiesh në zemër një pikëllim njerëzor
për vëllanë që ta vranë midis drurëve...
Ti s'e di cili qe emri i tij,
por atë edhe drurët ta thonë.

KODRA E VIKAMES

Nga pipëtima më e vogël e erës,
bari rrëqetthej, drurët oshëtinin,
thirrja gufonte nga mushkëritë e dheut.

Ndryshonin armët që shtinin mbi ne,
ndryshonin duart që vinin të na digjnin:
thirrja e saj mbetej e njëjtë...

Armiqtë s'do ta gjejnë kurrë në gjumë
këtë tokë që kushtimet i mban
edhe nënofullat e gurëve.

GURËT E BARDHË

Ata gurë zbardhin midis barit
si plisa të bardhë malësorësh.

Ata gurë qëndrojnë në shi e breshër
si kraharorë burrash para plumbave.

Ata gurë të bardhë krah për krah
si burra të lidhur me shoka të larme.

Ata gurë të bardhë krah për krah
si trupat e tyre të përgjakur...

Gjashtëmbëdhjetë gurë si gjashtëmbëdhjetë burra
krah për krah në jetë e në pasvdekje.

ZËRI I GURËVE TË BARDHË

Mos u gabo, more rrugëtar,
ne nuk jemi gjashtëmbëdhjetë gurë të bardhë:
ne jemi gjashtëmbëdhjetë burra
që u vramë krah për krah.

Patëm lindur në ditë të ndryshme,
s'e mendonim që mund të vdisnim, në një ditë...

Por edhe njëqind herë po të lindnim,
s'do ta ndërronim vdekjen tonë
me këtë vdekje pa rënë në gjunjë,
me këtë vdekje krah për krah.

GURI I PARË

Atë ditë vere, atë ditë gjëme
ishim, mbledhur të shtinim, në varr
shokun tonë që kishte në trup
plumbat e ushtarëve të kralit.

Të mos kishte ardhur tinëz si ujk,
kurrë s'do të na kishte zënë të gjallë
Savë Batarja!

GURI I DYTE

Na rrethuan me të pabesë,
s'na lanë të futim në dhë shokun tonë,
mos i lëntë as varri brenda,
por ua gjuajttë përjashta eshtrat!

Gratë lotonin rrëth varrit të hapur:
qanin të vdekurin, na qanin ne...

ZËRI I GURËVE TË BARDHË

Na lidhën bashkë me shokat e larme,
që nuset tona i patën endur.

Të lidhur bashkë me ato shoka të larme,
dukeshin si malet kur i lidh ylberi.

Shi e diell në sytë e nënave tona,
në sytë e nuseve tona — shi e diell...

Sy ndër sy me pushkët e kralit,
qëndruam si male të lidhura me ylberë.

GURI I TRETE

Në mos ma pafsh fytyrën, ani.
Në mos ma ditsh emrin, ta thotë ky gur.

Te këto gështenja me myshk e ketra,
te kjo lëndinë me lule të bardha
më vranë plumbat e Savë Batares.

Më erdhi keq për lulet e bardha
që u përgjakën nga varrët e mia.

Më erdhi keq për barin e njomë
që e shtypa pak me trupin tim.

Zogjtë e malit ikën të trembur,
i lanë shkretë çerdhet në degë...
E vranë verën ata plumba.

GURI I KATËRT

Më mbeti ara pa ujitur.

Po pëlciste në degë gjinkalla,
ishin fishkur gjethet e misrit.

Kush do ta ndjekë ujin në vija,
kush do t'i njomë bucat e tharë?

Më trishton ara që digjet,
më trishton ajo këngë gjinkallah!

GURI I PESTË

E kam lënë tufën në bjeshkë,
e kam lënë fyellin në lugje të tbanit,
gjithë rudinat ende s'i kam shkelur...

Pa mua tufa do të vëtmohet,
tërë ditën do të blegërojë në kullotë.

Do të ndryshket fyelli im te tbani,
bari i ri do të thahet rudinave
e prej mallit do të marrë flakë.

Zëri im si zog i truar
do të endet bjeshkë në bjeshkë.
Kur të ulet të pijë te gurra,
uji i borës do të fshihet nën tokë.
Kur të pushojë në degët të ahut,
nga dhimbja dega do të thyhet.
Kur të kërkojë një vend për të fjetur,
zgavrat e shpellat do të mbyllen...

Zogu i truar i zërit tim
do të zbresë rrugës së vërrinit,
do të pushojë veç te ky vend,
te këta gurë që mbinë në gjak.

GURI I GJASHTË

Më vranë pa e bërë dasmën time,
pa i dëgjuar tupanat në kullë,
pa e prekur gërshtetin e nuses.

Kur ta marrë vesh e bukura ime
që më vranë ushtarët e kralit,
penjtë e vekëve do t'i presë,
do ta ngjyejë shaminë në verr.

Do të hipë në kalë të zi,
kur të shkojë te burri tjetër.

GURI I SHTATË

Një kullë të re e pata nisur
mbi hirin e kullës që ma dogji krali.

Pa ardhur vjeshta me ërë e shishtuq sëtë
do t'ia vija çatinë prej pishe,
ku do të shkisnin flokët e borës.

E lashë kullën pa e mbaruar...

Mos u mjero, moj kullë e bardhë,
s'të lënë vellezërit pa të mbaruar!

Po ta fal edhe ashtin tim,
ta kesh murin më të fortë se guri,
për t'i pritur gjylet e huaja.

Po ta fal edhe gjakun tim,
të mos tunden gurët e themelit,
kur të gjuajnë kralët me topa.

GURI I TËTË

E kam lënë gruan shtatzënë.

Djalit që nesër do të lindë
emrin tim ka për t'ia ngjitur,
pushkën time do t'i japë...

S'mund ta vrasin emrin tim
as tërë plumbat e shtatë kralëve!

Djali im do të vijë këtu,
do t'i shohë këta gurë të bardhë,
do të pyesë për këta gurë:
do ta dijë kush na ka vrarë.

Edhe në u fshehtë gjakësi ynë,
në sqep të orlit, në dhëmb të ujkut,
s'do të mbetemi gjakhumbur.

Më mbeti nëna kërcunë në vatër,
më mbeti nëna me duar në gji.

Kur ta marrë malli për mua,
drue se i shkim yjzit në qiell,
drue se e nëm dritën e hënës
dhe hëna mbytet në lotin e saj...

Do ta çojë parmendën tek ara,
qetë e kuq do t'i mbrehë në zgjedhë
nëna ime pa djalë në vatër.

Zogjtë e malit do të habiten:
Si lëron parmenda pa lavërtar?!

Do ta veshë nëna një cung të zi
me tirq të rinj, me plis të bardhë.
Armët e mia do t'i varë në cung,
të mos duket nulla e shkretë,
të mos ulen qyqet mbi kulm...

Do ta shohin ushtarët e kralit
cungun me armë në oborr të kullës:
do të kujtojnë se prapë jam ngjallur!

GURI I DHJETË

A e dëgjon atë hingëllimë kali
që s'pushon ditë e natë?

Mos më thuaj që s'e dëgjon:
është gjoku im që hingëllin
dhe çukërmon te pragu i derës.

S'do të lodroj më me të fushave,
s'do të vrapoj me të në dasma:
unë shalova këtë gur të bardhë...

Gjoku im te grazhdi i errët
natë e ditë do të hingëllijë.

GURI I NJËMBËDHJETË

Te mrizi i madh ku del një gurre,
do të takoja të dashurën time.

E dashura ime aty do të presë,
do t'i mbushen sytë me mijegulla vjeshte,
do t'i digjen faqet prej lotëve.

Degët e ahut do tē pérkulen,
do t'ia prekin supet e flokët.
Gjethet e holla do tē pëshpëritin
fjalët që u ngrinë buzët e mia,
por loti i nxehté do tē pikojë:
do t'i gërryejë rrënjet e ahut,
do ta brejë gurin e gjollëve.

Gjethet e kuqe do tē bien prej ahut,
do ta mbulojnë tē dashûrën time,
tē mos e ngrijnë erërat e ftohta,
tē mos i zbardhen flokët prej brymës.

GURI I DYMBOËDHJETE

E pata prerë në pyll një panjë:
tri lahuta prej saj do t'i nxirrja,
tri lahuta me krye dhie,
me shqiponjë e gjarpër në bisht.

Mbetën brenda në trung tē panjës,
ato lahuta s'do tē bien kurrë...

Era e malit që përplas degët,
që oshëtin në gryka e hone,
si ato lahuta do tē këndojet.

Kur të fryjë era e malit,
lërini hapur dritaret e kullave:
ajo ju sjell krismat që na vranë,
ajo ju sjell fjalët tona të fundit.

GURI I TREMBËDHJETË

Mori nënë, mos qaj për mua:
qaje pushkën që s'm'u ndodh pranë!

Ta kisha pasur pushkën me vete,
plumbat e mi do t'i kishin shpuar
gradat e arta të Savë Batares.

Do të largohej në kalë druri
Savë Batarja me grada të djegura,
deri në zemër të kralive
do të ndihej kukama e zezë...

GURI I KATËRMBËDHJETË

S'më erdhi keq, bre, që më vranë;
më ra gjaku në dheun tim.

Toka ime më mori në gji,
varrët e shtatit m'i lau me vesë,
gjakun e tyre e ktheu në lule...

Më rëndon ky dhé mbi trup:
I pata dhënë besën shokut që vdiq,
t'i merrja gjakun tek ushtarët e kralit.

Më ka zënë dheu me besë të dhënë,
nuk po mundem ta çoj këtë gur.

Mos e harroni besën time!

GURI I PESËMBËDHJETË

Kur u ndezën flakët e pushkëve,
kur ma shpuan plumbat këmishën,
u turbulluan gurrat e bjeshkës,
nuses sime iu dogjën gishtat.

Njëzet plumba ma çanë kraharorin,
e kërkuan kudo zemrën time
ta çukisniň ime sqepa orlash...

Si mund të vritej me njëzet plumba
zemra ime sa shtatë bjeshkë,
që kishte brenda fusha e male,
pishnaja të blerta, lumenj të kthjellët?!

Çdo gur bjeshke është zemra ime,
rrënjet e barit janë damarët e saj.

GURI I GJASHTËMBËDHJETË

Më bërtiten ushtarët e kralit:
Hajt, o plak, në shtëpinë tënde!
Deshën të m'i ligështonin shokët,
t'u plaste zemra prej trishtimit,
kur të më shihnin duke ikur.

I shikova në dritë të syrit
dhe u thashë ushtarëve të kralit:
Do të rri me këta djem të rinj,
do të rri të vdes me ta.

Si mund ta pres vdekjen më mirë
se krah për krah me kësi djemsh?!

ZËRI I GURËVE TË BARDHË

Kur i kthyen pushkët drejt nesh,
u ndal dielli, s'bënte dritë...

Le të vritemi nga plumbi i huaj,
por ti, diell, kurrë mos u ndal,
mos i shuaj rrezet e bardha
as nga tymi i zi i pushkëve,
as nga kobet, as nga vdekjet.

ZËRI I GËZHOJËS SË NDRYSHKUR

A e sheh, more rrugëtar,
më ka ndryshkur shiu i moteve,
m'u ka mbushur gryka me baltë.

Mos kujto se jam gëzhojë;
unë jam goja e Savë Batares,
që kam thënë «Zjarr!» një mijë herë.

A i sheh këta gurë të bardhë?
Dikur qenë gjashtëmbëdhjetë burra,
të gjatë, të drejtë si gjashtëmbëdhjetë lisa.

Desha të dridheshin para meje
këta burra me duar të lidhura,
këta burra para pushkëve
deshë t'i shihja të rënë në gjunjë...

U bërtita, i shoftë murtaja:
Bini në gjunjë që t'ju fal jetën,
Lypini mëshirë Savë Batares!

ZËRI I GURËVE TË BARDHE

Edhe n'i rrëzofsh lisat e malet,
edhe n'e shembsh qellin mbi ne,
nuk të biem kurrë në gjunjë,
more qen i zi i kralit!

ZËRI I GËZHOJËS SË NDRYSHKUR

Prapë bërtita, i kërcënova,
por asnjë s'më ra në gjunjë.

Atëherë thirra «Zjarr!» sa munda
dhe i pashë tek binin përtokë
duke u mbajtur tek njëri-tjetri,
duke u mbajtur te dheu i tyre.
As të vdekur s'më ranë në gjunjë!

ZËRI I GURËVE TË BARDHË

Mbaje mend, more rrugëtar:
Ne nuk jemi gjashtëmbëdhjetë gurë të bardhë,
por ne jemi gjashtëmbëdhjetë burra.

Flakët e pushkëve i pamë me sy,
me kraharor i pritëm plumbat...

Ndalu pak këtu, o rrugëtar i çdo kohe.
Në qofsh nënë, preki këta gurë me duar.
Në qofsh nuse, hidhna sipër një lule.
Në qofsh vërritar, sillna një dorë kallinj...
Në qofsh bjeshkëtar, lëre një tufalak pishe.

Në qofsh dasmor, mos e pre këngën në mes,
këndo!

Në qofsh duke shkuar diku për mort,
mos loto!

Në qofsh duke vrapuar për të pritur dushmanin,
t'u bëftë këmba flatër zogu!...

Në qofsh i ri, në qofsh i largët,
fytyrat tonë kërkoi te nipat.

Ashti ynë i shpuar prej plumbash
bar të ri nxjerr mot për mot,
mbi këta gurë që u përgjakën,
zogu i verës ulet e këndon.

Shënim: Më 1915 ushtria shoviniste e kralit pushkatoi 16 malësorë te Shkalla e Grisë, ku populli nguli 16 gurë të bardhë.

Të desha si pylli gjethet

TË DESHA...

Të desha si pylli gjethet që shpërthejnë në prill,
të desha si lumi brigjet me gëmusha e mëllenja,
të desha si gruri që piqet diellin e zjarrtë,
të desha si rrënja e bimës ujin në thatësirë,
megjithatë më dukej sikur të doja pak.
Të desha si dega e bredhit flokët e borës,
të desha si pema e çelur fluturimin e bletëve,
të desha si rruga në agim hapat e kalimtarit
 të parë,
të desha si lastari i hardhisë vilen e rrushit,
megjithatë më dukej sikur të doja pak.
Të desha si vatра nё dimër vezullimin e prushit,
të desha si teli i violinës harkun që i bie,
të desha si syri i ёndërrimtarit yllin e largët,
të desha si fëmija balonën e kaltër nё qiell,
megjithatë më dukej sikur të doja pak.
Të desha si mushkëritë ajrin e pyllit nё verë,
të desha si syri lotin e dhembshur,
të desha si kraharori psherëtimën e mallit,
të desha si buza e etur burimin e kthjellët,
megjithatë më dukej sikur të doja pak!

JAM I MBUSHUR ME DRITË...

Eci fillikat këtë mbrëmje,
por fjalën vetmi s'mund ta kuptoj.
Lumi kurrë nuk është vetëm:
ai ka oshëtimën e tij.
Zogu në hapësirë nuk është vetëm:
ai ka këngën në kraharor.
Ylli në qiel nuk është vetëm:
ai ka rrezet që lëshon.
Si mund të jem i vetëm sonte,
me dashurinë që kam në zemër?!

Eci fillikat nëpër rrugë,
por fjalën trishtim s'mund ta kuptoj.
Po t'i thërrisja një peme,
do të vinte të ecte bashkë me mua.
Po t'i thosha kalldrëmit: Blero!
Do të nxirrte në çast bar e lule.
Po t'i thosha Afërditës: Eja këtu!
Do të vinte të digjej pranë meje...
Si mund të jem i trishtuar sonte,
me dashurinë që kam në zemër?!

Eci fillikat nëpër natë,
por fjalën errësirë s'mund ta kuptoj.
A mos jam një xixëllonjë e dehur,
që i ka ngatërruar stinët?!
Hënë, po deshe, ik nga qelli:
aty do të var zemrën time!
Ruga më duket e pafundme
si një hapësirë ndëryjore.
O, son te digjet brenda meje
trupi i një meteoriti të panjohur...
Jam i mbushur me dritë,
jam i mbushur me gëzimin që e pashë:
Sa e bukur që dukej,
më e bukur se në përfytyrimet e mia!

I D A S H U R U A R

Jam i kthjellët si hapësira pas ditësh me shi,
kundërmoj bar të ri, pemë të çelura,
në sy kam diej të panumërt si lumi,
në buzë, në gishta, në supe kam zogj
që nxjerrin cicërima të padëgjuara ndonjëherë.
Kam një këmishë të prerë nga një re e bardhë,
kam këpucë të lehta, të buta prej myshku,
në pëllëmbët e mia të hapura lulëzojnë zambakë,
ajri që thith, mban erë trëndelinë.

Dridhem lehtë si gjethja e hollë e ahut,
brinjët e mia bien si fyej të magjishëm,
hesht si stralli plot xixa të zjarrta,
në vend të fjalëve nga goja më dalin pëllumba,
dëshirat mugullojnë në mua, rriten si drithëra.
Tërë pemët rrëth meje bëjnë mollë të arta,
e marr për dore një rrëkë dhe ajo vjen me mua
deri në heshtjen e dhomës ku ëndërroj për ty,
rrugët ku ke ecur më vijnë te kryet e shtratit,
më sjellin fjalët, të qeshurat që ke lënë në to.
Fytyra jote e pakapshme më rrëthon si ajri,
fle në syrin tim për t'u zgjuar të nesërmën
si agimi në mes të pyllit me lisa dhe bar.

TI JE LARG

Ti je larg... Dhe unë e ndiej mungesën tënde,
siç ndien një njeri mungesën e krahut të humbur,
siç ndiejnë pemët në qershor ikjen e pranverës.
Ti je larg. Tani trupi im është dhimbje dhe mall.
Zëri yt më kumbon në veshë si një motiv
me violinë
që era e sjell përmes degëve dhe dritares së hapur.
Ti je larg. Të gjithë drurët më bëhen shtylla
telefoni
për të folur me ty dhe në gjethet e panjave
shkruaj fjalë dashurie që s'arrita kurrë të t'i them.
O, do të doja të isha një nga këto re të shtyra
nga era,
që mbase do ta lëshojë shiun atje ku je ti!

KAM DËSHIRË TË DËGJOJ ZËRIN TËND

Kam dëshirë të dëgjoj zërin tënd:

Mos më thuaj se në të nuk fshihet një burim
që gurgullon nëpër barin e lulet e një livadhi
që nuk zverdhet kurrë.

Mos më thuaj se në frymën tënde nuk fryn
erë limonësh të lulëzuar.

Mos më thuaj se sytë e tu të mëdhenj, fëmijërorë
nuk janë yjtë e mbrëmjes së parë që u ndezën mbi
tokë.

Mos më thuaj se flokët e tu nuk janë muzgje vere
ku shushurijnë grunjërat dhe këngët e bulkthave...

Kam dëshirë të dëgjoj zërin tënd:

Mos më thuaj se në të nuk fshihet një burim.

Mos më thuaj se fytyra jote nuk është një zog
i bardhë

që futet nëpër gjumin dhe ëndrrat e mia.

Mos më thuaj se nga qerpikët e tu nuk ngrihet
një trumbë dallëndyshesh

që më sjellin prillin në mes të janarit.

Mos më thuaj se krahët e tu nuk janë lastarë
hardhie
ku piqet mushti i të prekurave që mund të dehin
burrin.

Mos më thuaj se kur ti prek me duar librat
e rëndë,
nuk drithërohen në varre eshtrat e dijetarëve
të vdekur...

Kam dëshirë të dëgjoj zërin tënd:
mos më thuaj se në të nuk fshihet një burim.
Mos më thuaj se ylberi nuk është shilarësi
ku ti ke luajtur në fëmijëri.
Mos më thuaj se nuk kemi ecur buzë detit
duke mbledhur guaska.
Mos më thuaj se nuk të kam hedhur nga degët
e larta vile qershie.
Mos më thuaj se nuk kam ëndërruar për ty
në livadhet e bjeshkëve.

Mos më thuaj se di të shprehëm më mirë se fëmija
që ka zënë të flassë.

Mos më thuaj se nuk do të jetoj një mijë e
një vjet,

për të thënë atë që ndiej për ty...

Kam dëshirë të dëgjoj zërin tënd:
mos më thuaj se në të nuk fshihet një burim
që rrjedh drejt meje nëpër të gjitha motet.

P A G J U M Ė S I

Natë pa gjumë.

Unë mendoj pér ty.

Vargje tē papritura më vijnë në buzë,
siç vjen te një ditë vere shiu.

Yjet vezullojnë matanë dritares.

Një qen ulërin në largësi.

Një merimangë ëndërron flutura tē vrara.

Një trëndafil hapet në errësirë.

Një mi bren dërrasat e kalbura.

Dielli shtegton nëpër orbitën e tij.

Yjet vezullojnë matanë dritares.

Qeni ulërin prapë në largësi.

Merimanga ëndërron flutura tē vrara.

Secili vuan nga pagjumësia e tij.

Natë pa gjumë.

Unë mendoj pér ty.

ECJA NËPËR HESHTJEN E PYLLIT

Ecja nëpër heshtjen e pyllit me pisha
si në një faltore të lashtë me shtylla mermeri.
Pylli i lagur nga shiu i mbrëmshëm
kundërmonte në diell.
Thithja erën e rrëshirës, erën e athët të gjetheve
që kishin nisur të kalbeshin.
Ecja me ty në sy. Ecja duke menduar për ty.
Tërë hapësira e pyllit mbushej me praninë tënde.
Tërë vetmia e pyllit mbushej me fjalët
dhe lëvizjet e tua.
Ti ishe pranë çdo druri duke më pritur,
duke më vështruar përmes qerpikëve.
Ecja nëpër pyllin e lagur e të heshtur me ty në sy.
Ecja duke menduar për ty
dhe ndieja një lëmsh në grykë...

MIDIS NESH BINTE SHI

Ti po vije përballë meje në trotuarin tjetër.
Të ndoqa me sy: asnjëherë s'e ktheve kokën
nga unë.

Në rrugë binte pareshtur shi i ftohtë,
sikur ngrinte mure të hirta midis nesh:
mure që s'do të mundem t'i shemb asnjëherë.
Ti ike. Sytë e mi mbetën të zbrazët

si trotuaret e lagura.

Mbetën të mjegulluar si pasqyrat
dhe xhamat e vitrinave
që mbajtën pak më parë imazhin tënd.

Pikat e shiut trokitnin ritmikisht në trotuar,
sikur mbërthenin me gozhdë

një qivur të padukshëm.

Unë ecja rrugëve, ndanë pasqyrave
dhe xhamave me avull,
sikur u lutesha të ma kthenin imazhin tënd.

Në rrugë binte pareshtur shi i ftohtë,
sikur ngrinte mure të hirta midis nesh:
mure që s'do të mundem t'i shemb asnjëherë.

VAJZA E REVE TË BARDHA

I shtrirë te bari që kundërmonte verë,
me hije të blertë më mbështillte një ulli;
si udhëhumburi që thërret në humnerë,
një mijë e një gjinkalla cirreshin për shi.

Në zgrip të qiellit u dynd një tufë resh
të bardha, të fryra, të lehta si shkumë:
duke luajtur, ktheheshin në kuaj, në desh,
në përbindësha ëndrrash që shohim në gjumë.

Papritmas një re që u shtoll ngadalë,
u shndërrua në kokën e një vajze që desha:
me një lumë të turbullt na ndau një fjalë,
urë e shembur midis nesh mbeti heshtja...

Retë u shprishën, u tretën nga rrezet e diellit,
fytyrën e vajzës s'e pashë më askund;
të habitur mbetëm përballë njëri-tjetrit
unë, ulliri dhe ai qiell i pafund.

HARRO GJITHÇKA

Është e kotë gjithçka... Mos kërko të ngresh në
këmbë
midis hirit të fjalëve të harruara e të paharruara
pemën e dashurisë sonë të djeshme:
ajo nuk do të ngjallet më si ato vashat e bukura
që u ngulnin një gjilpërë në kokë
magjistaret e përrallave.

Lëre dashurinë në kohën e saj
me atë muranë dhimbjeje e heshtjeje
të përjetshme të kryet.
Lëri imazhet e dikurshme të vërtiten në bebëzat
tona
si zogj të ngujuar në një kafaz qelqi,
por mos provo t'ua hapësh derën:
qielli i tyre ka humbur një ditë vjeshte.
Lëri në qetësi fytyrat tona si fushëbeteja të moçme
ku rritet harrimi dhe bari.
Lëri buzët tona të ndara nga akulli i një dimri
që s'do ta shkrijë asnje verë.
Mos kërko ta kthesh kohën prapa:
ajo do t'i ngjante një përbindëshi
me kokë të ngjitur së prapthi mbi trungun e tij...

Mos më shiko. Mos më thuaj asgjë.

Mos kujto asgjë.

Harro se jemi parë ndonjëherë. Harro fytyrën time.
Harro fjalët e mia. Harro stinët

kur menduam e vuajtëm për njëri-tjetrin.
Është e kotë gjithçka... Mos kërko të kthehemë më
te një kohë që ka ikur përgjithmonë.

Çfarë po them?!... Kérko ç'të duash: në daç
drurëve këputua gjethet e gjelbra. Në daç
qiellit merrja retë e zogjtë.

Në daç hapësirave merrua erërat e yjtë
dhe léri të zbrazëta si zgavrat e syve

në kafkat e të vdekurve.

Në daç fjalët futi në një anije të madhe,

të plumbtë

e mbyti në fund të detit...

Por, të lutem, mos kërko të ringjallësh dashurinë e djeshme,
që e mbuluam me dhë të murrmë paragjykimesh,

interesash të vockla.

Është e kotë gjithçka, po të them... Mos u ndal.

Mos më fol.

Hesht dhe kalo!

NE TË DY...

Më duket sikur njihemi që nga krijimi i kësaj bote:
ne qemë njerëzit e parë të saj,
(Adami dhe Eva nuk ishin:
ata s'kanë qenë ndonjëherë!)
Rreth nesh pamë lulet e para, dëgjuam
zogjtë e parë,
nën këmbët tona bari zgjati fijet e tij,
në qiellin e mbrëmjes u ndezën yjtë e parë.
Ende s'ekzistonteurrejtja,
ende s'ishin shpikur mëkatet,
pemët na zgjatnin degët e tyre
të mbushura me fruta,
në flokët tanë flinte era,
në ballin tonë lindte hëna,
nga qerpikët e tu binte vesa...
Ne të dy ecnim të gëzuar mbi tokë.
Dikush na pa nga lartësia e fronit të tij,
iu errën sytë nga zilia:
atëherë shpiku perënditë, urejtjen, mëkatet,
shpiku xhelozinë,
sajoi ferrin, parajsën, rrrethin e artë.
Mijëra vjet rënkuam nën peshën e tyre.
Në emër të dashurisë së lirë e të kthjellët,
një ditë i mohuam perënditë,

mohuam ferrin, parajsën, mëkatet, urejtjen,
e copëtuam gjarprin e rrëthit të artë
dhe filluam rikrijimin e botës...
Të dy ecim të gëzuar mbi tokë.

E PUTHURA JOTE

Diku midis mjekrës e qafës sime
mbeti e puthura jote e shpejtë,
që më dhe në stacion atë ditë.

Ajo lulëzon në qafën time si një lule,
cicëron aty si një zog,
rojë e përhershme e dashurisë,
më e rreptë se të gjitha nenet,
ajo puthje malli,
ajo puthje e dëlirë.

TRENI LË PRAPA HORIZONTE

Treni lë prapa horizonte,
vendbanime, ura, kryqëzime rrugësh.
Ti më ndjek prapa kudo
po aq e afërt sa fjalët me buzët.
Ti vjen e më futesh në mendime.
Ti vjen e më futesh në ëndrra.
Më rri në bebëza si një zambak uji.
Ti je diku brenda meje,
që andej më shikon.
Ti jeton në mua.
Midis nesh s'ka hapësirë.
Midis nesh s'ka kohë të shkuar.

E D A S H U R

E dashur,
nuk mjaftoka tē përqafohem i nën një panjë:
duhet që rrugët e lumenjtë midis nesh
tē jenë zgjatim i krahëve tanë.

E dashur,
nuk mjaftoka tē puthemi me zjarr vetëm sone:
duhet që pas shumë stinësh e vitesh
buzët tonë tē mos jenë tē ftohta.

E dashur,
nuk mjaftoka tē tē them gjithë jetën «e dashur»:
duhet ta thotë edhe era rrëth nesh,
ta thotë pas nesh edhe bari.

LËRE DRITAREN TË HAPUR

Lëre dritaren të hapur
të vijë natën ai yll që vezullon në qiell,
të na puthë në gjumë,
të na tregojë përralla ose të vërteta
për gjithësinë,
të na sjellë në buzë
kaltërsinë e hapësirave që s'i pamë
dhe mbi qepallat e ulura
dritën e kohëve kur nuk qemë!
Lëre dritaren të hapur
të vijë natën ai yll që vezullon në qiell:
ai yll nën të cilin u deshëm.

PRILL

Tani ditët e mia janë dritare
për të parë fytyrën tënde,
për të hyrë brenda meje ajri i kundërmuar,
frymëmarrja e pyjeve, pafundësia
e qiellit të kaltër
dhe prilli i syve të tu.

Janë dritare tani ditët e mia:
nga secila shoh fytyrën tënde të bukur...

Nuk është si të tjerët ky prill!

* * *

E ç'kohë tjetër mund të ishte
veçse prill
për të të njojur ty?

Toka u rrotulla rrëth diellit
duke krijuar ditët e muajt
që të takoja ty në prill.

Dielli erdhi më afër tokës,
drurët nxituan të nxirrnin gjethe,
nxituan të ktheheshin dallëndyshet.

Lulet u ngutën të çelnin,
që të zbuluronin sheshet e rrugët
ku do të ecja për të ardhur te ti...

E c'kohë tjetër mund të ishte
veçse prill
për t'u takuar me ty?

* * *

Prillin gjithmonë e kam kërkuar te dielli:
tani e gjeta te bukuria jote.

Prillin gjithonë e kam kërkuar te vjollcat:
tani e gjeta në zërin tënd.

Prillin gjithmonë e kam kërkuar te vjollcat...
tani e gjeta në buzët e tua...

Nuk është si të tjerët ky prill,
moj e bukur!

* * *

Dashuria luan me fytyrën time
si moti në prill.

Aty kthjellet,
aty bie shi.

Aty i ngre ylberët,
aty i rropos në hapësirë...

C'është ky fëmijë i prapë,
që më hedh rreze me pasqyrë?

Asgjëkundi s'më lë të qetë,
m'i lëbyr sytë.

Si moti në prill
dashuria luan me fytyrën time.

* * *

Të dashurosh do të thotë të kesh në kraharor
një zemër dielli,
të kesh në trupin tënd bilbila që s'pushojnë
së këduari,

të mbështetësh kokën mbi një lumë kur të biesh
për të fjetur,
t'i prekësh me dorë si frutin e pjekur gjërat
e pamundura.
Të dashurosh do të thotë të ndiesh dhimbje
për çastet që ikin,
si njeriu kur sheh gjakun duke pikuar nga plaga
e thellë,
t'i ngjash malit në shtrëngatë, të kalërosh erën si
fëmijë,
të urresh vetminë si zogu që lë zgavrën nga etja
për qiell.
Të dashurosh do të thotë të jesh një qenie
e dyfishtë.
të ecësh zigzagut të nepërkës e të jesh i paprekshëm
prej saj,
mëngjeseve të gjesh mbi buzë trëndafila
të saposhpërthyer,
të hapen midis teje dhe kohës mijëra dyer e
dritare...

* * *

Të gjitha agimet u bënë rrugë
për të ardhur te ti.

Të gjitha mbrëmjet u bënë drurë të blertë
për të të pritur ty.

Të gjithë muajt u bënë prill
për të dashruar ty.

Fjalët papritmas u dehën
në verën e damarëve të mi...

E ç'kohë tjetër mund të ishte
vecse prill
për t'u njojur me ty?

* * *

Ku e kam parë fytyrën tënde,
moj e bukur?

Mos e kam parë te një baladë e lashtë,
që gjyshërit e këndonin me lahutë?

Mos e kam parë te liqene bjeshkësh,
ku kriheshin në hënë shtojzovallet?

Mos e kam parë te statujat e mermerta,
që juga u hedh sipër lule portokalli?...

* * *

Fytyrën tënde e kam parë në Myzeqe,
duke bashkuar me krahët e metaltë të shinave
hapësirat dhe brigjet e lumenjve.

Fytyrën tënde e kam parë në Vermoshin e largët,
duke rrëzuar me duart e buta
shkrepat e ashpër si statuja patriarkësh.

Fytyrën tënde e kam parë në Lukovë e Jonufër,
duke qëndisur kodrat me brezare
si xhubleta nusesh...

Ti mund të mos kesh qenë në ato vise,
por vajzat që kam parë atje,
moj e bukur, kaq shumë të ngjisnin ty!

Nëpër gjurmët e hapave të tu
mugullon bari i ri.

Tërë lulet e pemëve lidhin kokrra,
kur ti ecën midis tyre.

Mbështet mbi libra pëllëmbët
dhe aty fryjnë erërat e prillit.

Te fjalët hapen qiej të kaltër
dhe aty jehon zëri yt...

* * *

Në këtë tokë të sertë
çelte bukuria
si trëndafil i egër.

Ia rrëzonte fletët era e dhimbjeve
dhe breshri i plumbave
trëndafilit të bukurisë.

Mbetej në sy të kohës bukuria e vashave
shkëlqim vetëtime,
vegim ankthi.

Zgjatej klithma e tyre
nëpër muzgje baladash...

* * *

Moj e bukur,
ti qesh me kohët që ikën.

Në buzagazin tënd
loti shndërrohet në mit.

Në buzagazin tënd vdes koha e kanuneve,
koha ime qesh.

Në buzagazin tënd është gëzimi i kësaj kohe
si lumi te cirka e vesës.

* * *

Edhe sot dikush prodhon bomba
të djegë fytyrën tënde.

Edhe sot dikush shpik shëmti
të errësojë bukurinë tënde.

Edhe sot dikush përpinqet
të shterojë qumështin e gjirit tënd...

Do të rrjedhë qumështi yt i ngrohtë,
do të mëndë fëmijë të lumtur —

Ditë të mëdha do të mëndë.

* * *

Ata s'mund ta vrasin jetën,
s'mund ta vrasin gëzimin e bukurisë,
s'mund ta vrasin dashurinë.

Me atë këmbëngulje qëjeta krijoj diellin,
me atë këmbëngulje që krijoj tokën tonë,
me atë këmbëngulje që të lindi ty:
me atë këmbëngulje të mbron.

Me atë këmbëngulje që drita mund errësirën,
bukuria mund shëmtimin.

Është e pamposhtur bukuria e botës,
është e pamposhtur dashuria
siç është i pashmangshëm prilli.

* * *

O, ç'paskam sot një dëshirë fëmije
t'i hukat me frymën time të ngrohtë
të gjitha burbuqet.

T'i mbledh të gjitha lulet e livadheve,
të t'i sjell ty, moj e bukur.

T'i bëj fyej të gjitha degët
e t'u bië për ty.

T'i ngroh me duar vezët nëpër çerdhe,
të çelin më shpejt dallëndyshet...

E ç'kohë tjetër mund të ishte
veçse prill,
kjo kohë dashurie?!

* * *

Të gjithë muajt ndërruan vendin
për t'ia dhënë ditët prillit.

Të gjithë muajt erdhën si krushq
në gëzimin e dashurisë sonë.

Dhjetori i ra bririt të erës,
janari të solli kristale bore.

Shkurti të bëri një gjerdan yjesh,
marsi i fryu gajdes së burimeve.

Maji të vuri lulëkuqe mbi flokët e zinj,
qershori t'i ngjeu buzët me qershi.

Korriku t  hodhi grur  mbi supet e lehta,
gushti ta praroi trupin me rreze.

Shtatori mbushi kupat me musht t  ri,
tetori akordoi pianon e shirave.

N ntori na uroi si gjysh rit:
B fshi nj  vat r f mij !

* * *

Nuk  sht  si t  tjer t ky prill,
moj e bukur.

Qiejt e tij t  kthjell t
jan  syt  e tu.

Agimet i krijon
me t  qeshur n t nde.

Muzjet kan  but sin 
e flok ve t  tu t  dendur.

Fytyra jote e bukur
 sht  fytyra e k tyre dit ve...

Nuk  sht  si t  tjer t ky prill.

Prill 1984.

MURIMI NË FJALË

*Vura fjalën bri fjalës si gurët në mur,
i gdhenda me nge si shkëmbinj të rëndë,
të puthiten fort si fijet në pëlhirë,
pesha e njëra-tjetrës t'i mbajë në këmbë.*

*Radhët e fjalëve u ngritën breza-breza,
me to u ndërtua një pirg i lartë:
nga brigjet e kohës ia behu era,
para syve m'i lëkundi si kashtë.*

*Për t'i bërë si ashti fjalët e brishta.
në themel të tyre flijova vetveten:
me gjak të kuq i lidha, i mpiksa,
nga zgavra e plasa përzura vdekjen.*

*Lashë në mur një dritare, një sy,
një dorë të hapur zgjata mbi botë:
që ta dijë fisi i erës se jam aty,
prej pirgut pikon gjak nëpër kohë.*

PËRMBAJTJA

Urtia e zogjve

GURËT DHE FJALËT

Hapësirat	4
Në shregullën e pranverës	5
Përtëritja	7
Te varri i Enver Hoxhës	8
Çunakët	9
Zëri që të dha zemër	10
Ulliri i lashtë	12
Flijimi	14
Gurët dhe fjalët	16
Nuk është e vërtetë	18
Sharkia e Dervish Shaqes	20
Ura pa lumë	22
Vajzat punëtore te Parku i Madh	24
Nëna	25
Pushi i krahëve të fluturës	26
Vizita e stërgjyshit	27
Kipci im	29

ECI NËPËR DITËN TIME

Punëtorët që shtrijnë linjat e reja telefonike	31
Autokritikë në vetën e dytë	32
Eci nëpër udhën time	34

Burokratët i krijoni ju	35
O ti, djalë i fshesares	38
Kështjellat e fëmijëve në bregdet	39
Vajza që ecën në trotuar	40
Natyryshmëri	43
Ti sillesh nëpër dhomë	44
Po zverdhen gjethet nëpër drurë	45
Mbrëmje me shi në Tiranë	46
Kuajt e kinostudios	47
Fotografia	48
Fëmijë të përkëdhelur	49
Poeti vëngérash	50
Dhe fryn juga e bardhë	51
Ora pesë ka kaluar qëkur	52
Krushqi	54
Maska	55
Në urban	56
Pemët në dimër	58
Një mikroborgjezi	59

LUMI E DI KU BURON

Duhet të bëhem më i ri	61
Një re e bardhë	63
Ngjitja e sondës së parë në Malin e Hekurave	64
Testamenti i Sadri Isufit	65
Zogjve të vendlindjes	66
Im atë	68
Kulla ku kam lindur	70
Në livadhet e verës	71
Koha e dinjitetit	73
Në hijen e pemës	74
Shpyllëzimi i Pyllit të Pritave	75
Mbrëmje korrijesh	77
Lejlek u i fëmijërisë	78
Cunakut me gjunjë të përgjakur	79
Mali më thërrret	80

BARI NËN GUR

Njeriu i burgosur për një këngë trimërie	82
Katërkëndëshi i zi	83
Bari nën gur	85
Prometeu dhe orli	86
Skënderbeut	87
Mallkimi i shkëmbit	88
Gjarpri	89
Mërgimtari	90
Shqetësimi i Bertolt Brehtit	91
Dështimi i milingonave	92

KOHA QË NUK MATEȚ

Koha banon në ballin tim	94
Xhokat e zeza	95
Nezimi	96
Fotiola	97
E diel beratase	98
Luftëtarë Kombëtar në Korçë	99
Flutura krahëbardhë	100
Në breg të detit fryn juga	101
Trimat që ranë në det	103
Detari plak	104
Të lutem, Kolomb, vazhdoje udhëtimin tënd!	105
Babai i poetit	107
Partizani i pamposhtur	109
Kur të kalosh pyllit në vjeshtë	110
Kodra e Vikamës	111
Gurët e bardhë (poemë)	112

TË DESHA SI PYLLI GJETHET

Të desha	128
Jam i mbushur me dritë	129
I dashuruar	131

Ti je larg	1
Kam dëshirë të dëgjoj zërin tënd	1
Pagjumësi	1
Ecja nëpër heshtjen e pyllit	1
Midis nesh binte shi	1
Vajza e reve të bardha	1
Harro gjithçka	1
Ne të dy	141
E puthura jote	143
Treni lë prapa horizonte	144
E dashur	145
Lëre dritaren të hapur	146
Prill (poemth)	147
Murimi në fjalë	153